



UNIVERSITETI I EJL
ЈНЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY

Universiteti i Evropës Juglindore

Fakulteti i Bisnesit dhe Ekonomis

Dega Menaxhment

Teza e masterit

Tema: “Ndikimi i krizës financiare në industrinë e lehtë me theks në sektorin e fasonit”

Mentor:

Prof.Dr. Sadudin IBRAIMI

Punuar nga :

Arjan TOME

Falenderime

Së pari dua të falenderoj Udhëheqësin Shkencor të kësaj teze, Prof. Dr. Sadudin Ibraimi i cilime kontributin e tij shkencor dhe metodikmë ka konsultuar gjatëgjithë realizimit të këtij punimi. Pa udhëzimet e tij kjo tezë nuk do të kishte arritur formën aktuale

Dua të shpreh mirënjohjen për familjen time, shoqen time të jetës dhe kolegët e mi të cilët me praninë, durimin dhe kujdesin e tyre, ma bënë më të lehtë përfundimin e këtij punimi.

Ju faleminderit të gjithëve!

PËRMBAJTJA

Falenderimet.....	2
Përmbajtja e tezës.....	3
Abstrakt.....	5
Hyrje.....	6
Arsyet e zgjedhjes së kësaj teme.....	7
Qëllimi i përgjithshëm.....	7
Objektivat	7
Metodologjia.....	8
Kufizimet e studimit.....	8

PJESA E PARË

HISTORIKU DHE RËNDËSIA E FASONIT NËSHQIPËRI.....	9
1.1 Industria e fasonit në Shqipëri.....	9
1.1-1 Çfarë është sektori i fasonit.....	9
1.1-2 Historiku i fasonit në Shqipëri.....	10
1.2. Rëndësia e sektorit të fasonit	11
1.2-1Sektori i fasonit si punëdhënësi më i madh në industrinë e manifakturimit.....	11
1.2-2Tërheqja e investimeve të huaja direkte.....	12
1.2-3Forcimi i aftësive thithese teknologjike të firmave lokale.....	12
1.2-4Zëri kryesor i eksporteve shqiptare.....	14

PJESA E DYTË

NDIKIMI I KRIZËS EKONOMIKE TEK FASONET NËSHQIPËRI.....	15
2.1. Kriza ekonomike në një vështrim të përgjithshëm.....	15
2.2. Nisja e krizes ekonomike në sektorin e fasonit, efektet e saj.....	15
2.3. Ndikimi i reformave qeveritare në sektorin e fasonit.....	18
2.4. Pozicioni konkurrues i Shqipërisë në tregjet globale.....	20
2.4-1 Disavantazhet e Shqipërisë në krahasim me vendet e tjera.....	21
2.4-2 Avantazhet konkurruese të Shqipërisë.....	23

PJESA E TRETË

STUDIMI I EFEKTEVE TË KRIZËS NË RAJONIN E KORCËS	27
3.1. Rasti i studimit.....	27
3.2. Perspektiva e industrisë së fasonit në të ardhmen	
Konkluzione.....	37
Rekomandime.....	39
Aneks.....	41
Terminologjia.....	46
Tabelat.....	48
Grafikët	48
Literatura.....	65

Abstrakt

Shqipëria është bërë pjesë përbërëse e nismave për liberalizimin dhe lehtësimin e tregtisë në nivel rajonal dhe më gjerë. Pjesëmarrja aktive në këto nisma shton mundësitë e sektorit të fasonit për tu zhvilluar dhe njëkohësisht kërkon angazhime në drejtim të rritjes së konkurrueshmërisë. Treguesit e tregtisë së jashtme të këtij sektori, reflektojnë rëndësinë e madhe që ka për ekonominë shqiptare, për këtë arsye analiza dhe vlerësimi i kësaj industrie merr një rëndësi të veçantë

HYRJE

Mundësitë e rritjes ekonomike të vendeve që janë ende në zhvillim, ashtu si edhe Shqipëria, janë shumë pakta, dhe për këtë arsye, këto vende janë të detyruara të shfrytëzojnë ato industri të cilat kanë kosto më të ulëta kryesisht të fuqisë punëtore, si psh. industria tekstile dhe ajo e këpucëve. Industri e cila pas viteve 1990, edhe pse me shumë peripeci ka arritur të zhvillohet dhe të tërheqë mjaft investime të huaja.

Kjo temë synon të paraqesë një analizë të industrisë së fasonit të veshjeve dhe këpucëve në Shqipëri e fokusuar kryesisht në efektet direkte dhe indirekte të krizës ekonomike në këtë sektor. Tema është strukturuar në tre pjesë.

Në pjesën e parë trajtohet historiku i fasonit të veshjeve dhe këpucëve në Shqipëri, karakteristikat, rëndësia ekonomike dhe sociale e kësaj industrie .

Në pjesën e dytë trajtohen vështirësitë me të cilat u përball industria e fasonit si rezultat i krizës ekonomike.

Në këtë kuadër trajtohen edhe politikat qeveritare që kanë ndikuar negativisht në këtë sektor si dhe angazhimi i përfaqësuesve të biznesit për të përballuar situatën. Gjithashtu në këtë pjesë trajtohet dhe pozicioni konkurrues i Shqipërisë krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit dhe të Europës Qëndrore dhe Juglindore.

Në pjesën e tretë trajtohet efekti i krizës ekonomike në rajonin e Korçës dhe dimensionin social i sektorit bazuar në një studim në disa firma të fasonit. Gjithashtu një rëndësi i është kushtuar edhe mundësive që ka ky sektor në Shqipëri për të zhvilluar në të ardhmen. Pjesë e rëndësishme e temës janë rekomandimet për qeverinë, bizneset e fasonëve dhe sindikatat për ta bërë më konkurrues këtë sektor jo vetëm në nivel kombëtar por edhe evropian

ARSYET E ZGJEDHJES SË KËSAJ TEME

Rëndësia që ka sektori i fasonit për ekonominë shqiptare dhe për rajonin e Korçës.

Sektori i fasonit u prek më tepër nga kriza ekonomike për shkak të strukturës të organizimit që ka.

Në rajonin e Korçës nuk është bërë asnjë studim për këtë sektor, prandaj studimi ofron një bazë analitike për fasonet.

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM

Tema ka për qëllim analizimin e industrisë së fasonit (veshje +këpucë) në Shqipëri gjatë krizës ekonomike, ndikimet e dyfishta negative dhe pozitive të saj dhe identifikimin e alternativave dhe ndërhyrjeve të veçanta me qëllim shfrytëzimin e oportuniteteve të tregut për zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori.

OBJEKTIVAT

Të japim një paraqitje të shkurtër të historikut, karakteristikave dhe rëndësisë së fasonit në Shqipëri.

Të analizohet ndikimi i krizës ekonomike dhe reformave të qeverisë në industrinë e fasonit në Shqipëri.

Të analizohen avantazhet dhe disavantazhet e Shqipërisë në sektorin e fasonit krahasuar me vende të tjera.

Të analizohet ndikimi i krizës ekonomike në bizneset e fasonit në rajonin e Korçës dhe aspekti social duke evidentuar disa nga problemet me të cilat ndeshen punonjësit e këtij sektori.

Të identifikohen oportunitetet e sektorit për tu zhvilluar në të ardhmen.

METODOLOGJIA

Studimi i efekteve të krizës ekonomike në sektorin e fasonit të veshjeve dhe këpucëve në rajonin e Korçës bazohet në kombinimin e informacioneve prej burimeve primare dhe sekondare. Për të përfutur informacione primare janë realizuar 13 pyetsorë për firmat e fasonit për të parë si ka ndikuar kriza ekonomike në aktivitetin e tyre në terma të shitjeve, rezultatit financiar dhe punësimit. Pyetsori u strukturua me pyetje të hapura dhe të

mbyllura me një/disa mundësi zgjedhje. Nga 13 firma të marra në studim 12 ishin prodhues të konfeksioneve të veshjeve dhe 1 për prodhimin e këpucëve.

Gjithashtu u realizuan dhe 155 pyetsorë për punonjësit e këtyre firmave nga të cilët 5 ishin të pavlefshëm. Pyetsori u fokusua në element të tillë si kualifikimi, sigurimi, kontratat e punës, pagat, kushtet e punës të punonjësve. Studimi u realizua gjatë muajit maj, 2014.

Si burime sekondare janë përdorur informacione statistikore dhe jostatistikore zyrtare të raportuara nga: INSTAT, ACIT, BB, OECD, informacione nga shtypi i shkruar, Drejtoria e Doganave në Korçë, EUROSTAT.

KUFIZIMET E STUDIMIT

Studimi ka patur disa kufizime që lidhen me faktorë të jashtëm si:

Të dhëna statistikore të vjetra ose mungesa e tyre për disa tregues që lidhen me Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri në sektorin e fasonit, investimet në teknologji, të dhëna kontradiktore në lidhje me punësimin në këtë sektor.

Mungesa e gadishmërisë të disa firmave për të pranuar pyetsorin sidomos atë që lidhej me punonjësit.

Studimet e kufizuara në sektorin e fasonit nga ana e organizmave shqiptare. Në përgjithësi studimet janë bërë nga institucione të huaja. Mungesa e studimeve në këtë sektor në rajonin e Korçës.

PJESA E PARË

➤ HISTORIKU DHE RËNDËSIA E SEKTORIT TË FASONIT NË SHQIPËRI

Në periudhën komuniste u deklarua si objektivi primar kalimi nga një vend agrar dhe gjysëm feudal, në një vend industrialo-agrar ku prioritet do të kishte industria e rëndë. Me prishjen e marrëdhënies dhe humbjen e mbështetjes nga ish-Bashkimi Sovjetik, zhvillim mori industria tekstile dhe e keqecëve, një proces prodhimi që realizohej vetëm nëpërmjet rritjes të brendshme të prodhimit. Me prishjen e sistemit totalitar, kjo industri ndryshoi duke marrë lëndën e parë nga importi por duke prodhuar po në Shqipëri për shkak dhe të kostos së ulët të fuqisë punëtore. Kjo ka bërë që për këtë industri të rritet dhe interesi i investitorëve të huaj.

Kjo pjesë do të fokusohet në analizimin e veçorive të sektorit të fasonit dhe të rëndësisë së tij në drejtim të punësimit, terheqjes së IHD-ve, të forcimit të aftësive teknologjike të firmave vendase dhe rëndësisë në eksporte.

1.1. Industria e fasonit në Shqipëri

1.1-1. Çfarë është sektori i fasonit?

Fason do të thotë të punosh/prodhosh me material të porositësit. Pra deri tani firmat shqiptare të specializuara në qepjen e rrobave të ndryshme dhe të proceseve të prodhimit të këpucëve, marrin pjesë vetëm në hallkën e prodhimit. Ndërsa sigurimi i lëndëve të para, teknologjia, marketingu, tregjet e shitjes së produktit të gatshëm etj, sigurohen nga firma porositese e huaj.

Meqenëse krahu i punës në Shqipëri nuk është shumë i specializuar, dhe është i përqëndruar më tepër në sektorin e prodhimit, edhe produktet e eksportuara nga vendi ynë përgjithësisht konsistojnë në veshje dhe këpucë.

Pra industria e fasonit është e organizuar sipas sistemit me material porositësi (fason) të gatshëm ose gjysëm të gatshëm, për tregjet e huaja përgjithësisht drejt vendeve të BE ose ndryshe njihet si regjimi i përpunimit aktiv¹.

¹**Përpunimi Aktiv** është ai rregjim doganor që të lejon të importosh mallra në Shqipëri, ose të përdorësh mallra me origjinë shqiptare, me qëllim të përpunimit ose procesimit, dhe rieksporimit të mallrave kompensuese nga Shqipëria. Kodi Doganor

Industria e tekstileve dhe këpucëve paraqet disa veçori:

është një sektor i bazuar intensivisht mbi krahun e punës si avantazh kryesor konkurrues, kjo industri ka koston e lirë të fuqisë punëtore; industria është tërësisht e varur nga kontraktorët dhe ka kosto të fiksuara të materialeve dhe çmimeve të shitjes, që përcaktohen nga partnerët e huaj. Pra industria nuk mund të manovrojë ndaj një rritjeje të koston se fuqisë punëtore, duke rritur çmimet, sic ndodh me industrinë e tjera është industria që ka raportin më të lartë shpenzime personeli/shifra e afarizmit², në krahasim me të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë. Sipas përfaqësuesve të sektorit ky raport arrin në rreth 75%.

1.1.2. Historiku i sektorit të fasonit

Sektorët e këpucëve dhe veshjeve janë pikënisja më e zakonshme për zhvillimin industrial në ekonominë në zhvillim.

Rrjedhimisht edhe në vendin tonë këto dy industri zinin vendin kryesor në prodhim nga produktet primare e deri në produktin final për konsum brenda dhe jashtë vendit. Këto industri vazhdojnë të jenë më të zhvilluarat në vendin tonë edhe pas privatizimit në vitet 90' por me ndryshimin thelbësor që sot nevojat vendase plotësohen kryesisht nga importi.

Në vendin tonë numri i ndërmarrjeve të fasonit është rreth 480 prej të cilave, rreth 300 janë të përfshira në sistemin e kompjuterizimit të shërbimit doganor ASYCUDA, dhe që qarkullojnë mbi 4.5 miliardë lekë si xhiro ekonomike. Përqëndrimi më i madh i investitoreve të huaj në këtë industri si dhe numrit të firmave gjendet në qytetet e Tiranës, Durrësit, Korçës, Shkodrës, Vlorës. Arsyet e përqëndrimit në këto zona:

- Janë zona me të ardhura më të larta
- Kanë një infrastrukturë më të zhvilluar
- Tregu i punës është më i madh
- Pozita gjeografike është më e favorshme

² Shifra e afarizmit (të ardhurat nga shitja ose xhiroja)

Përpos kësaj, në pjesën pjesa tjetër të vendit këtë industri nuk e gjejmë shumë të zhvilluar për shkaqe të ndryshme si infrastruktura e dobët, migrimi dhe emigrimi etj.

Disa karakteristika të ndërmarrjeve shqiptare në këtë sektor :

Janë kryesisht me madhësi të vogël ose mikrondërmarrje (SME)

Ndërmarrjet më të mëdha bazuar në numrin e punonjësve janë kryesisht të huaja ose me pronësi të përbashkët

Janë të integruara horizontalisht (ofertë vetëm në një produkt ose shërbim), mungon oferta e integruar vertikalisht.

1.2. Rëndësia e sektorit të fasonit

Rëndësia e sektorit të fasonit shfaqet në disa drejtime:

1.2-1. Sektori i fasonit është punëdhënësi më i madh në industrinë e manifakturimit

1.2.2. Tërheqja e investimeve të huaja direkte

1.2-3. Forcimi i aftësive thithëse teknologjike të firmave lokale

1.2-4. Zëri kryesor i eksporteve shqiptare

1.2.1. Rëndësia e industrisë së fasonit në punësim

Kjo industri është një nga ofruesit kryesorë të punësimit për vendin tonë, duke marrë parasysh edhe faktin që jemi një vend ende në zhvillim, ku pjesa më e madhe e popullsisë nuk janë të kualifikuar, dhe kjo industri ofron vende pune edhe për këto shtresa, gjithashtu edhe për anëtarë të komunitetit rom. Ky sektor përbën rreth 14% të punësimit total në vend.

1.2.2. Rëndësia e sektorit në tërheqjen e investimeve të huaja

Me rënien e sistemit komunist, si çdo sektor tjetër i ekonomisë, edhe kjo industri pati luhatjet e veta, por arsyet e sipërpërmendura, dhe mbi të gjitha kostoja e ulët e fuqisë puntore, kanë bërë që të jetë gjithmone një sektor mjaft atraktiv ndaj investitorëve të huaj. Një faktor tjetër që ka

ndikuar në zhvillimin e kësaj industrie kanë qenë dhe politikat fiskale të ndjekura nga ana e qeverisë.. Gjermania, Greqia dhe Italia janë investitorët më të mëdhenj.E megjithatë, nqs nëvendet fqinje, flukset e investimeve të huaja kanë qenë më të qëndrueshme, në vendin tonë keto flukse kanë patur luhatje mjaft të mëdha³.

Arsyet e tërheqjes së investitorëve

a-kostot e ulëta të fuqisë punëtore

b-afërsia me tregjet europiane

a-Kostot e ulëta të fuqisë punëtore

Krahasuar me vendet e tjera të rajonit, ku kostoja e punës zë një përqindje mjaft të lartë të kostos totale të prodhimit, krahu i lirë i punës përbën një avantazh shumë të rëndësishëm për Shqipërinë, si pasojë, ky faktor është një nga burimet kryesore të tërheqjes së IHD-ve.

b-Afërsia me tregjet europiane

Avantazhi afatgjatë i Shqipërisë në këta dy sektore është afërsia e saj me tregjet e BE. Pozita gjeografike e Shqipërisë lehtëson tregtinë me këto tregje dhe përmbush një nga kërkesat thelbësore të konsumatorëve evropiane: shpërndarje të shpejtë dhe fleksibël.Shqipëria është një urë lidhese e shkëlqyer ndërmjet Europës Perëndimore dhe tregjeve në vendet e tjera të Ballkanit.

1.2.3. Përhapja dhe përmirësimi teknologjik i firmave të fasonit

Spektori i fasonit ka nje rëndësi të madhe edhe në forcimin e aftësive absorbuese teknologjike të firmave lokale. Përfitimi i njohurive teknike dhe teknologjike për indusrinë e lehtë ndihmon në përmirësimin industrial, ndikon në zgjerimin e eksporteve në tregjeve më të përparuara dhe krijon mundësi për eksporte të teknologjisë më të lartë. IHD ndikojnë në transferimin e teknologjisë nëpërmjet investimeve të reja, transferimit të informacionit dhe lehtësimit të përhapjes së teknologjisë nëpër firmat vendase.

³Dokument i BB “Shqipëria .Rritja e konkurrueshmërisë në Shqipëri” Raporti II. Tetor 2009

Përhapja teknologjike në vendet në zhvillim si Shqipëria, varet nga dy faktorë kyç:

1. nga masa e ekspozimit të firmave ndaj njohurive të huaja, veçanërisht në terma të IHD-ve, importet e të mirave kapitale dhe eksporteve të teknologjisë së lartë .

2. nga kapaciteti i firmave vendase për të thithur teknologjitë e reja dhe të avancuara.

1. Marrja e njohurive prej eksportit.

Importet e huaja të pajisjeve dhe makinerive të avancuara janë burimi kryesor i transferimit teknologjik për vendet në zhvillim, të cilat mundësojnë rritjen e produktivitetit që sipas studimeve, mund të arrijnë një nivel prej 50-120 %, në vartësi të intensitetit të përmirësimit teknologjik. Pjesëmarrja në tregjet e eksportit mepërqendrim-teknologjik është parë gjithashtu si një kanal përmes të cilit teknologjia shpërndahet në vendet në zhvillim. Shumë studime kanë treguar se firmat e eksportimit në vendet në zhvillim përfitojnë nga transferimet implicite dhe eksplicite të teknologjisë gjatë procesit të ndërveprimit me blerësit e huaj të cilët shpesh kanë standarde më të larta se sa klientët lokal.

2. Kapaciteti i firmave vendase për të thithur teknologjitë e reja

Ekspozimi ndaj teknologjive të përparuara, njohurive dhe aplikimit të tyre përmes tregtisë IHD-ve dhe rrjeteve globale të prodhimit është i nevojshëm për përmirësimin teknologjik, por masa e shpërhapjes së kësaj teknologjie dhe njohurie në ekonominë lokale vendoset nga aftësitë thithëse të kësaj teknologjie nga ana e ndërmarrjeve. Ndërkohë që kapaciteti thithës i një firme varet nga tre grupime faktorësh kryesorë:

-Faktori i parë i brendshëm për firmën, që përfshin në veçanti aftësitë teknologjike të forcës punëtore dhe kapacitetet menaxheriale.

-Dy faktorët e tjerë janë të jashtëm dhe përfshijnë;

klime e investimeve dhe mjedisi ku bizneset veprojnë i cili ndikon në iniciativën e tyre për të investuar dhe për tu rinovuar (duke përfshirë aksesin ndaj financimeve, qeverisjes, shërbimeve infrastrukturore etj);

cilësia e infrastrukturës dhe politikave të tjera publike.

1.2.4. Sektori i fasonit si zëri më i rëndësishëm në eksportet shqiptare

Ky sektor është shndëruar ndër më të rëndësishmit përse i përket përqindjes që zë në totalin e eksporteve shqiptare. Shqipëria ka përjetuar një rritje të fuqishme të eksporteve të sektorit të fasonit që prej vitit 2000. Eksportet e fasonit përbëjnë gati 50% të eksporteve totale të vendit

tonë dhe rreth 5% të GDP-së duke patur një ndikim të ndjeshëm në futjen e valutës dhe në bilancin tregëtar (grafiku 1.1 tregon % që zë ky sektor në eksporte dhe importe në periudhën 2005-2010). Italia është destinacioni më i madh i eksporteve shqiptare. Më tepër se 70% e eksportit të veshjeve dhe rreth 90% e eksportit të këpucëve shkon për këtë treg dhe pjesa tjetër e eksporteve kanë si destinacion Greqinë dhe Gjermaninë. Shqipëria renditet si vendi i gjashtë në botë për eksportin e këpucëve.

Disa faktorë kanë ndikuar në nivelin e lartë të eksporteve:

- Preferencat tregëtare të BE janë një shkak i rëndësishëm për vërshimin e eksporteve shqiptare që prej vitit 1999. Që në vitin 1992, Shqipëria ka përfituar nga Sistemi i Përgjithshëm i Preferencave të BE. Liberalizimi i mëtejshëm i tregëtisë së fasoneve u krye përmes Preferencave Tregëtare Autonome ndërkohë që në vitin 2000, Preferencat Asimetrike Rajonale ju dhanë Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit (Bosnjë-Hercegovina, Kroacia dhe Maqedonia), që lejoi detyrime doganore “zero” për eksportet në Tregëtinë për Proçesim të Huaj (OPT), konkretisht eksporteve që ishin prodhuar duke përdorur materiale që e kishin origjinën nga BE apo vendi përfitues. Gjithashtu Shqipëria është anetare e OBT që prej vitit 2000 si dhe përfiton nga Marrëveshjet e Tregëtisë së Lirë disa prej të cilave janë:
 - Marrëveshja e Përkohshme Shqipëri - BE
 - Marrëveshja e Tregëtisë së Lirë e Evropës Qendrore (CEFTA)
 - Marrëveshjet Dypalëshe
 - Shoqata Europiane për Tregëtinë e Lirë (EFTA). Bazuar në këto marrëveshje taksat për produktet shqiptare që hyjnë në tregun europian ulen në zero.

Gjatë muajve të fundit të vitit 2008 dhe në vazhdim të vitit 2009 si rezultat i krizës së përgjithshme botërore, pati një ulje të eksporteve dhe një sërë pasojash të tjera që e vunë në vështirësi këtë industri.

PJESA E DYTË

➤ NDIKIMI I KRIZËS EKONOMIKE TEK FASONET NË SHQIPËRI

Shqipëria, duke qenë një vend në zhvillim, nuk ishte një nga vendet më të ekspozuara ndaj krizës globale, por kjo nuk do të thotë që efektet e saj nuk u ndien. Në qoftë se marrim si rast konkret industrinë tekstile, do të shohim se ka qenë një nga sektorët më të prekur nga ky kolaps.

Në këtë pjesë do të trajtohet ndikimi i reçesionit global në industrinë e fasonit dhe efektet zinxhir negativë në tregues të tillë si: rrënia e eksporteve, prodhimi, rritja e papunësisë, dhe humbja e aftësive konkurruese. Do të trajtohen edhe disa politika të qeverisë që nga biznesi i fasonit janë cilësuar si diskriminuese dhe kanë thelluar më tej krizën.

Gjithashtu do të analizohet pozicioni konkurrues i Shqipërisë në tregun europian duke trajtuar disa probleme që kanë penguar konkurrueshmërinë, por edhe avantazhet dhe potencialet që ofron ky sektor për tërheqjen e investitorëve të huaj. Interesi i këtyre të fundit për Shqipërinë është në rritje si rezultat i disa efekteve indirekte positive që solli kriza dhe disa politikave stimuluese nga ana e qeverisë shqiptare.

2.1. Kriza ekonomike në një vështrim të përgjithshëm

Një stuhi e përsosur! Kjo është metafora e përdorur për të përshkruar krizën globale të vitit 2008. Asnjë nga rëniet e tjera ekonomike pas Luftës së Dytë Botërore s'kanë qenë kaq të ashpra sa ky reçesion. Arsyeja kryesore e kësaj krize ishin kreditë e këqija. Kjo solli falimentimin e shumë bizneseve dhe institucioneve financiare, të shoqëruara këto me një sërë faktoresh të tjerë negativë për ekonominë mbarë botërore. Në këtë kuadër edhe Shqipëria nuk mund të ngelej jashtë kësaj stuhie, megjithëse pasojat ishin më pak të ndjeshme. Ndikimi direkt i krizës ekonomike mbi vendet në zhvillim si Shqipëria, vihet re në rënien e kërkesës për produktet e eksportit, rënien e investimeve të huaja direkte dhe shtrëngimi i kushteve të huamarrjes. Por sipas FMN integrimi i ulët i ekonomisë shqiptare në atë botërore dhe në tregjet financiare zbuti disi efektet e krizës⁴.

Një ndikim të ndjeshëm kriza ekonomike e pati në një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare, atë të fasonit.

⁴ IMF:Preliminary Report 2010

2.2-Nisja e krizës ekonomike në sektorin e fasonit, efektet e saj

Kriza ekonomike globale i zhyti në një kolaps kompanitë fasoniste. Efektet e saj filluan të ndjeheshin në muajin tetor të vitit 2008, duke patur një ngadalësim të dukshëm të rritjes së eksporteve në këtë sektor. Europa gjithashtu u ndikua ndjeshëm. Nga një studim i KPMG/Market me 3700 prodhues të anketuar, pesimistët “me të medhenj” ishin ata të industrisë së kepuceve dhe tekstile, ku pritshmëria mesatare si për perspektivën e fitimeve dhe të punësimit në sektorin e veshjeve dhe të këpucëve ka kaluar për herë të parë në vlera negative (-19.1%), që kur ky vëzhgim filloi në janar të vitit 2006⁵.

Në vendin tonë edhe për faktin se fasoni është tërësisht i varur nga ecuria e sipërmarrjeve tekstile europiane, sidomos atyre italiane, sepse punon tërësisht me material porositësi nga kontraktorët e huaj ky efekt u ndje edhe më tepër. Kërkesa më e ulët nga partnerët ndërkombëtarë ka qënë dhe një nga arsyt kryesore të stepjes së eksporteve të tekstileve dhe këpucëve.

Gjatë muajve të parë të vitit 2009, industria eksportuese e fasonistëve vuajti pasoja të rënda, por më të goditurit ishin prodhuesit e veshjeve. Prodhuesit e këpucëve u përballën gjithashtu me rënien e kërkesës nga Italia dhe vende të tjera perëndimore, duke u detyruar të shkurtojnë një pjesë të forcës punëtore. Por rënia për këtë segment ishte më e vogël krahasuar me atë të veshjeve. Kriza ekonomike solli një sërë efektesh negative zinxhir si më poshtë:

- Reduktimi i eksporteve duke ndikuar negativisht në bilancin tregëtar dhe atë të pagesave
- Rënie të prodhueshmërisë
- Rënie të nivelit të punësimit
- Ndikimi në aftësitë konkurruese të firmave të fasonit

Kriza e ekonomike që filloi ti jepte efektet e saj në tre mujorin e fundit të vitit 2008, pati një ndikim më të ndjeshëm në vitin 2009. Eksportet kanë shënuar gjatë muajit dhjetor të 2008 rënien më të lartë mujore historike gjatë këtyre viteve të fundit. Në vitin 2007 rritja e eksporteve ishte me 19%, në fund të vitit 2008 kjo rritje ishte vetëm 4.5 %. Eksportet e konfeksioneve të veshjeve në 2009 ranë me 11 % dhe të këpucëve me 5.2% në krahasim me 2008.

Mbi 50 ndërmarrje në rang vendi ndërprejnë pjesërisht apo tërësisht veprimtarinë e tyre prodhuese gjatë periudhës së krizës. Kjo situatë pati ndikim në punësim, ku rreth 11 mijë punonjës në shkallë vendi janë pushuar ose larguar përkohësisht nga puna. Ky është dhe treguesi

⁵ Revista monitor: Artikulli “Kriza godet fasonin” Prill 2009

kryesor i rritjes së nivelit të përgjithshëm të papunësisë⁶. Ndikimin e krizës e tregon edhe një studim i ACIT.

Qendra Shqiptare për Konkurueshmerinë dhe Tregëtinë (ACIT) mbështetur nga Fondacioni SOROS dhe në bashkëpunim më DHKPV, realizoi një studim për të parë efektet e krizës në industrinë e fasonit.

Pjesë thelbësore e studimit ishin dy pyetësorë: një për fasonistët dhe tjetri për të punësuarit e këtyre bizneseve. Këto kategori u përfaqësuan nga 77 biznese dhe 225 punonjës të shpërndarë në tre qytete të ndryshme: Tiranë, Korçë, Shkodër.

Rreth 57% e kompanive deklaroi që kishte patur rënie të shitjeve gjatë vitit 2009. Përafërsisht e njëjta shifër reflektohej edhe në tremujorin e parë të 2010 (58%). Përsa i përket rezultatit financiar, rreth 55% e kompanive të pyetura deklaruan që norma e fitimit është ulur ndjeshëm gjatë vitit 2009. Të pyetur mbi shkaqet e këtyre rezultateve, përfaqësuesit e kompanive shprehen se faktorë kryesorë janë rënia e kërkesës në tregjet e eksportit, rritja e kostove të prodhimit dhe mosrespektimi i kontratave nga ana e partnerëve të huaj.

E ndërkohë që kriza në Europë dhe në botë vazhdonte të ishte prezente, bizneset në Shqipëri ishin optimiste se dicka do të ndryshonte.

Rezultatet e para u ndien në fillim të vitit 2010, ku fale masave të mara si: kërkimi për tregje të reja, përmirësim i cilësisë dhe imazhit të produktit, pakësim i forcës punëtore dhe kredi shtesë ose ristrukturim i kredive ekzistuese, u vu re një rimëkëmbje e kësaj industrie. Treguesit ekonomike faktojnë se dicka ndryshoi, (një rritje me rreth 14 për qind të eksporteve me prodhime të fasonit, veshje dhe këpucë) rikuperimi i ekonomisë filloi të jepte shenjat e para në Itali dhe Greqi, te ciët janë dhe bashkëpunëtorët tanë kryesorë, gjë e cila u transmetua dhe tek prodhuesit shqiptarë.

Nga totali i eksporteve të këtij sektori, rreth 70 % i zë Italia, me 27 miliardë e 876 milionë lekë, Gjermania me rreth 2 miliardë, Greqia me 1 miliard e 755 milionë lekë, e më pas vendet e tjera, që zënë një peshë monetare eksporti rreth 1 miliard e 700 milionë lekë. Vetëm në muajin Korrik, eksportet e tekstileve dhe këpucëve kanë pësuar një rritje të konsiderueshme me rreth 700 milionë lekë, ose gati 13 për qind, me një vlerë 5 miliardë e 495 milionë lekë. Arsye e rritjes se

⁶ Bardhi Sejdarasi: “Kur flasim për krizën”.Gazeta “Korça” Shkurt 2010

eksporteve në këtë periudhë është dhe ndërrimi i stinëve. Kështu në vitin 2010 eksportet e konfeksioneve u rritën me 7.3% ndërsa eksportet e këpucëve me 26.6 % ⁷(tabela 2.1). Në rritjen e eksporteve të këpucëve ka ndikuar edhe vendosja e një tarife 20 % nga BE për këpucët e eksportuara nga vendet aziatike. Megjithatë luhatjet e vazhdueshme në treg të këtij sektori reflektojnë praninë e krizës. Pozitat e sektorit të fasonit janë vështirësuar jo vetëm nga kriza ekonomike, por edhe nga disa reforma të qeverisë që janë cilësuar si diskriminuese nga biznesi i fasonit.

2.3.Ndikimi i politikave qeveritare në sektorin e fasonit.

Rritja e çmimit të energjisë, rritja e pagave minimale si dhe ndryshimet e shpeshta fiskale në mes të vitit kanë dëmtuar këtë sektor, për shkakun e thjeshtë se kompanitë fasoniste punojnë me kontrata të mbyllura që në fillim të vitit, pra me çmime të fiksuara nga kontraktorët e huaj dhe çdo ndryshim ndikon ndjeshëm në normën e tyre të fitimit. Kështu disa nga reformat që kanë patur efekte negative janë:

Rritjet e pagës minimale dhe paga e referencës
Problemet me rimbursimin e TVSH-së
Ritja e akcizës dhe çmimit të energjisë

a)Rritjet e pagës minimale dhe paga e referencës

Një nga nismat e Qeverisë që ka pasur ndikim më të madh negativ në sektorin e fasonëve ishte vendosja e pagës së referencës. Skema e pagave referuese u vendos për herë të parë në mes të vitit 2007, me synimin për të rritur të ardhurat e sigurimeve shoqërore.

Ky vendim rriti ndjeshëm pagën minimale mbi bazë të së cilës paguhen sigurimet shoqërore për këtë industri. Për punëtorë të pakualifikuar paga minimale bëhet 17,000 lekë, nga 14,000 që ishte më parë, ndërsa për punëtorët e kualifikuar bëhet rreth 26,000 leke, nga 15,000 deri 18,000 leke që paguhen aktualisht. Pra kemi një rritje mesatare të pages minimale prej 20- 40%. Pagat e referencës konsiderohen nga biznesmenët e kësaj fushe si mekanizmi më i dëmshëm që nuk lidhet me krizën ndërkombëtare.

Punëdhënësit detyrohen të paguajnë një pagë minimale prej 17 mijë lekësh për të gjithë punonjësit, pa marrë parasysh faktin se një pjesë e tyre mund të realizojnë prodhim me vlerë më të ulët si dhe të paguajnë tatimet dhe sigurimet shoqërore mbi këtë pagë referencë. Rritja e kostos kur qeveria vendosi pagën minimale 17000 lek llogaritej të ishte rreth 13 për qind më shumë, dhe në shifra absolute kjo rritje është (për një ndërmarrje me 50 punëtorë) rreth 367 mijë lekë më

⁷ ACIT: TRADE RAPORT 2010

shumë për pagat e punonjësve, ndërsa ajo me 200 punëtorë rreth 1.3 milionë lekë më shumë. Kështu pagat e punës variojnë nga 60-70% të shpenzimeve, ndërsa pjesa e sigurimeve shoqërore zë 15–20% të shpenzimeve, ndërkohë që sektorë të tjerë zërin e shpenzimeve për paga e kanë në nivelet 8-10% të shpenzimeve.

Në terma të fitimit, sipas përlllogaritjeve të DHKPV në një ndërmarrje me 50 punëtorë ka një humbje të fitimit vjetor prej 1,08 milionë lekë, që është afërsisht sa gjysma e të gjithë fitimit. Për ndërmarrjet e mëdha në numër punonjësish humbja e fitimit është akoma më e madhe dhe përlllogaritet në mbi 4 milionë lekë të reja. Sipas të dhënave DHKPVK, përlllogaritet se në total sektori i fasonit ka një humbje prej rreth 750 milionë lekësh nga vendosja e pagave të referencës⁸.

b) Problemet me rimbursimin e TVSH-së.

Duke qenë se industria e fasonëve në formën e organizimit punon për eksport dhe për pasojë zë një peshë relativisht të konsiderueshme në futjen e valutës së huaj në vend, e cila ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik të vendit, por dhe duke marrë në konsideratë dispozitat ligjore të vendeve fqinjë e me gjerë, TVSH-ja për këtë sektor rimbursohet. Por në të vertetë problemet për rimbursimin e TVSH-së janë të shumta për shkak të procedurave burokratike nga ana e administratës tatimore. Sipas përfaqësuesve më të lartë të këtij biznisi koha për rimbursim shkon deri në më tepër se një vit, gjë që përbën një rrezik të vazhdueshëm për biznesin e fasonit. Sipas një studimi të ACIT, vonesat në rimbursimin e TVSH kanë një ndikim të lartë në nivelin e likuiditetit për firmat e fasonit⁹.

c) Rritja e akcizes dhe çmimit të energjisë

Rritja e akcizës, për ambalazhet që përdoren në sektorin e veshjeve dhe këpucëve, ndikoi negativisht në treguesit financiarë të këtyre kompanive. Edhe rritja e çmimit të energjisë, për shkak se ky produkt vjen i dytë në radhën e shpenzimeve të planifikuara, pas atij të pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, ka dhënë ndikim në uljen e efektivitetit të investimeve në kompanitë fasoniste, në mungesën e likuiditetit dhe të kapitalit për të përmirësuar teknologjinë dhe në përgjithësi në performancën e këtyre kompanive, në kushtet kur konkurrenca në këtë treg rritet dita ditës.

⁸ Bardhi Sejdarasi: “Kur flasim për krizën” artikull në gazetën “Korça” Shkurt 2010

⁹ ACIT: Studim mbi Rimbursimin e TVSH për Eksportuesit . Qershor 2010

Pra siç shihet efektet e këtyre reformave për shkak të strukturës së kostos janë shumë të ndjeshme. Kështu rritjet e vazhdueshme të pagave minimale në periudhën 2007-2010 (17000, 18000,19000 lek) si dhe reformat e tjera të përmendura më lart janë shoqëruar me një sërë efektesh zinxhirë negativë si :

Rritja e ndjeshme e kostos së prodhimit

Ulja e avantazhit konkurrues të kostos së lirë të fuqisë punëtore

Interes më të ulët të investitorëve aktualë dhe atyre potencialë

Reduktim i normës së fitimeve për ndërmarrjet.

Rritja e kostos së fuqisë punëtore do të dekurajojë punëdhënësit për deklarinimin real të numrit të punonjësve dhe përfshirjes së tyre në skemën e sigurimeve.

Kërkesat e firmave të fasonit për qeverinë

Vështirësitë me të cilat u përball sektori këto vitet e fundit si nga kriza ekonomike dhe nga politikat qeveritare ka bërë që të rritej edhe më shumë angazhimi i përfaqësuesve të këtyre bizneseve. Për fasonistët, jo vetem kriza ekonomike botërore por edhe reformat qeveritare kanë dobësuar ecurinë e industrisë. Prandaj ata kanë kërkuar vazhdimisht ndërhyrjen e qeverisë për të ndihmuar këtë sektor në kapërcimin e krizës. Kërkesat kryesore të tyre përqëndrohen në disa pika:

- Heqja e taksës së tatim-fitimit për sektorin e fasonit për një periudhë 3-5 vjecare.
- Subvencionimin e pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e rinj për një periudhë 1-3 vjet, duke marrë përsipër që punëdhënësi të paguajë pagesën e papunësisë për sigurimin nga aksidentet në punë.Përrjashtimin deri në 50% të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë të punësuarit në këtë sektor për periudhën e krizës.
- Heqja e plotë e TVSH-së dhe taksave doganore për importimin e linjave të pajisjeve të prodhimit dhe mbështetje të tjera fiskale për ato biznese që kalojnë nga forma fasoni i pastër në prodhim “Made in Albania”
- Pagat mbi të cilat të paguhen detyrimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të jenë pagat reale të sektorit dhe jo ato referuese.
- Mbështetje për kualifikim profesional dhe nxitjen e punësimit.

Kriza ekonomike botërore dhe ndikimi i qeverisë kanë patur efekt të dyfishtë për industrinë e fasonit, nga njëra anë e kanë vënë në një situatë të vështirë këtë sektor por nga ana tjetër janë shoqëruar edhe me efekte indirekte pozitive duke ndikuar në aftësitë konkurruese. Në pjesën në vazhdim do të trajtohet potenciali konkurrues i Shqipërisë në industrinë e fasonit në raport me konkurrentët rajonalë.

2.4.Pozicioni konkurrues i Shqipërisë në tregjet globale

Shqipëria është pjesë e rrjetit global të prodhimit të veshjeve dhe këpucëve. Pas viteve 1990 prodhuesit shqiptarë u përfshinë në rrjetet globale të ofertës për segmentet e mesme të tregjeve të këtyre produkteve. Në këto kushte Shqipëria përballet me një konkurrencë jo vetëm në rajon por edhe më gjerë për terheqjen e investitorëve. Globalizimi i ekonomisë e ka bërë konkurrencën gjithnjë e më dinamike

Vendet në zhvillim janë pikat më atraktive për investitorët e huaj. Shqipëria, si pjesë e bllokut të vendeve në zhvillim, ka mundur të tërheqë disa investime të huaja, sidomos në sektorin e fasonit, por gjithsesi të pamjaftueshme për ta bërë atë konkurent në tregjet globale. Vendet që kanë mundur të thithin më tepër investime dhe të jenë krahasimisht më konkurruese se ne, janë vendet aziatike, afrikano-veriore dhe rajoni i Ballkanit. Si avantzhe mund të përmendim: krah pune më të gjerë dhe më të lirë, treg më të madh shitje, sasi më të madhe të lëndës së parë etj.

Nëqoftëse hedhim një vështrim në ecurinë eksportive, vëmë re një rënie të ndjeshme të tyre sidomos në industrinë e tekstileve dhe të këpucëve, kjo si shkak i vërshimit të produkteve të lira kineze në tregjet europiane. Por Kina dhe blloku aziatik nuk janë problemi ynë i vetëm. Megjithëpërpjekjet e vazhdueshme dhe masat e marra, faktorë të tillë si: cilësia e ulët e produktit dhe shërbimit, kapacitetet e pamjaftueshme të prodhimit, mungesa e aftësive menaxheriale, mungesa e teknologjisë apo pajisjet e vjetëruara, mungesa e kapitaleve, mungesa e informacionit se çfarë ndodh në tregjet e huaja etj. na bëjnë ne më pak atraktivë dhe të aftë për tu përballur me këtë konkurrencë kaq të egër në tregjet globale.

2.4.1. Disavantazhet e Shqipërisë në këtë sektor shfaqen në disa drejtime:

Klima e investimeve

Sipas studimeve të OECD, faktorët që kanë qenë më tepër shqetësues për ecurinë e Shqipërisë dhe që kanë penguar aktivitetin prodhues dhe me pas eksportin e mallrave, duke e krahasuar me vendet e tjera të rajonit, janë: fuqia punëtore, infrastruktura e dobët, mjedisi rregullator dhe vështirësitë në gjetjen e financimeve.

Fuqia punëtore

Problemet e ekonomisë në vendin tonë, vecanërisht ato që lidhen me fuqinë punëtore, janë dhe pasoja të historisë së Shqipërisë. Mungesa e vëmendjes ndaj arsimit profesional, infrastruktura e dobët nëpër shkolla, cilësia e ulët e mësimdhënies etj. kanë sjellë një numër të ulët të punëtorëve

të kualifikuar. Një faktor tjetër ka qenë dhe emigrimi i brezit të ri, i cili është dhe kontigjenti kryesor për tu përfshirë nëpër trajnime.

Gjithashtu edhe trajnimet që ofrojnë firmat, nuk janë në ato nivele për të krijuar një fuqi punëtore të mirë-trajnuar e aq më pak ekspertë teknikë.

Sipas një studimi të QKZH, mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar përbënte një pengesë shqetësuese për 63 % të firmave fasoniste ¹⁰.

-Infrastruktura

Një faktor tjetër pengues në zhvillimin e ekonomisë në vendin tonë është dhe infrastruktura. Gjithashtu mund të përmendim këtu edhe pengesat burokratike, probleme me energjinë etj. Të gjitha këto shkaktojnë vonesa si në prodhim ashtu dhe në shpërndarjen e produktit. Me kalimin e kohës një pjesë e tyre janë reduktura, por ka ende shumë punë për tu bërë.

-Mjedisi rregullator

Ashtu si dhe përmendet më sipër, një problem shumë i madh për biznesin fason janë pengesat burokratike, mungesa e informacionit, politikat ekonomike të cilat shpesh nuk janë në mbështetje të këtij biznesi, por e stepin atë.

-Gjetja e financimeve

Për arsye të ndryshme ky lloj biznesi nuk shihet si shumë i besueshëm nga ana e bankave për tu kredituar. Kjo bën që bizneset fasoniste të kenë mjaft probleme në gjetjen e financimeve në mbështetje të tyre. Si rrjedhojë është gjithnjë e më e vështirë ngritja e këtyre bizneseve.

Mungesa e diversifikimit të produkteve dhe tregjeve

¹⁰QKZH: "Rezultatet e vërtetimit të biznesit dhe konsumatorëve". Qershor 2007

Për shkak të një sistemi ekonomik të mbyllur, Shqipëria filloi të integrohet vetëm mbas vitit 1990. Si rrjedhojë, eksportet tona janë të përqëndruara në pak vende dhe ka mungesë diversifikimi të produktit, duke u mjaftuar kryesisht në këpucë dhe veshje.

Investimet e ulta në teknologji

Në përgjithësi investimet në teknologji në vendin tonë kanë qenë të ulëta krahasuar me vendet e tjera të rajonit, kjo për disa arsye si pamundësia financiare, paaftësia teknike e përdorimit të teknologjive të reja nga ana e punonjësve etj.

2.4.2. Avantazhet konkurruese të Shqipërisë

Pozita gjeografike

Pozita gjeografike strategjike e Shqipërisë është shumë më e favorshme se e Rumanisë, Bullgarisë, Kroacisë dhe vendeve të tjera të Afrikës Veriore. Aksesit i shkëlqyer me tregjet greke dhe ato italiane, i krijon mundësi Shqipërisë për një logjistikë tregëtare më të shpejtë dhe fleksibile, që është shumë e rëndësishme për investitorët. Afërsia gjeografike e bën Shqipërinë shumë konkurruese për porositë në sasi të vogla të klientëve të huaj. Kostoja e transportit është më e ulët krahasuar me vende të tjera dhe shumë më e ulët krahasuar me vendet aziatike.

Ligjet e punësimit

Ligjet e punësimit janë shumë më favorizuesë në Shqipëri se në vendet e tjera të rajonit. Investitorët europianë dhe sidomos ata italianë kanë patur të dislokuara teknologjitë e tyre drejt tregjeve të Europës Lindore, kryesisht në Rumani, Bullgari, etj. Me hyrjen e këtyre dy vendeve në BE u krijuan vështirësi të panumërta për këta investitorë. U standardizuan kushtet dhe kontratat e punës sipas ligjeve të BE-së mes punëdhënësve dhe punonjësve. Gjithashtu dhe ndikimi i kufizuar i sindikatave përbëjnë një element pozitiv

Kostot e lira të fuqisë punëtore

Edhe pse kostot e fuqisë punëtore dhe të prodhimit janë ritur, përsëri ato janë më të ulëta në krahasim me disa vende të tjera të Evropës Juglindore. Paga minimale në vendit tonë është ndër më të ultat midis vendeve që kanë potencial konkurrues në industrinë e fasonit. (grafiku 2.5).

Efektet pozitive në konkurrencë si rezultat i krizës ekonomike

-Përfaqësuesit e biznesit fasonist kanë marrë një sërë masash për të përballuar krizën;

Marrëveshja e unifikimit: Sipas një drafti të përgatitur nga GTZ dhe USAID, Dhoma e Fasonisteve të Shqipërisë u unifikua me Dhomën Kombetare të Veshjeve dhe Këpucëve, duke nënshkruar një memorandum mirëkuptimi të përbashkët. Ky unifikim ka patur si qëllim përfaqesimin e interesave të kompanive anëtare të tyre, për të siguruar një forum për diskutime dhe vendime në ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta nga kompanitë anëtare si dhe për të forcuar pozitën e kompanive shqiptare të fasonit në tregjet globale.

Kalimi në ciklin e mbyllur të prodhimit: Ndërsa më parë e gjithë industria e fasonit punonte me material porositës nga jashtë, kriza ka bërë që një pjesë të firmave të kryejnë të gjithë procesin e prodhimit në vend, nga materiali që e gjejnë vetë, deri te hallka e fundit, prodhimi i gatshëm.

Kërkimi i tregjeve të reja: Industrialistët e fasonit u përpoqën të përshtaten me kushtet e reja, duke kërkuar porositës alternativë në vende të ndryshme nga tregjet tradicionale, si Italia dhe Greqia.

-Treguesit e qëndrueshëm ekonomikë:

Impakti i krizës ekonomike globale ka qënë i ndryshëm në vende të ndryshme. Në vitin 2009 mesatarja e rritjes së GDP-së në Europën Juglindore ishte - 6.2 %, ndërkohë që në Shqipëri rritja ekonomike ishte 3.3% dhe inflacioni është në nivele të ulta. Situata ekonomike ofron më shumë siguri për investitorët.(tabela 2.4). BB e ka cilësuar Shqipërinë si vendin me ekonominë më të hapur dhe më dinamike në rajon.

Politikat nxitëse qeveritare

Kur tashmë për tregjet aziatike po krijohen jo pak probleme në shkëmbimet tregtare, kostot e fuqisë punëtore dhe të transportit janë në rritje si në tregjet aziatikë dhe në vendet e Europës Juglindore, ndërtimi i politikave strategjike në thithjen apo nxitjen e këtyre investitorëve tashmë të provuar në investime, do të ishte një element mjaft pozitiv për zhvillimin e ekonomisë së vendit tonë.Në këtë drejtim qeveria shqiptare e ndikuar edhe nga kërkesat e vazhdueshme të përfaqësuesve të fasonit, ka ndërmarë disa politika favorizuese për sektorin që kanë përmirësuar

klimën e investimeve, sidomos në thithjen e investimeve të huaja dhe në forcimin e aftësive konkurruese të këtyre firmave.

Politikat favorizuese të Qeverisë:

Taksa e sheshtë.

Heqja e tarifës doganore 12.5 %

Fondi për nxitjen e punësimit

Amnistia fiskale

Ulja e kontributeve të sigurimeve shoqërore për punëdhënësit me 5% (nga 20% në 15%)

-Taksa e sheshtë

Përgjysmimi i tatimit mbi fitimin nga 20% në 10%, në 2008 në kuadrin e taksës së sheshtë, do të nxit investimet në këtë sektor, sepse Shqipëria ka taksën e tatim-fitimit më të ulët në rajon. Shqipëria nuk ka kufizime për investimet e huaja.

-Heqja e tarifës doganore 12.5%

Në muajin prill të vitit 2011 qeveria hoqi tarifën doganore për fasonet, e cila më parë ishte 12.5%. Ky vendim është përkrahur nga fasonistet. Heqja e kësaj tarife do të inkurajojë më tepër këtë industri në rritjen e prodhimit, të eksporteve por njekohesisht edhe në nxitjen e punësimit. Heqja e kësaj takse pritet të rrit interesimin e sipërmarrësve që prodhonin në vendet arabe dhe që dëshirojnë të investojnë në Shqipëri, duke e konsideruar si një vend me klimë të përshtatshme për biznesin në Europën Juglindore.

-Fondi për nxitjen e punësimit

Fondi i kreditimit me interesa të buta për investime në makineri dhe teknologji, fondet e promovimit për eksportuesit të menaxhuara nga AIDA, projektet e ndërmjetësimit të transferimit teknologjik, programet e trajnimit janë disa nga masat e marra të qeverisë shqiptare për të mbështetur sektorin e fasonit. Këto masa do të stimulojnë më tepër këtë sektor për të hapur vende të reja pune.

-Amnistia fiskale

Në kuadër të amnistisë fiskale, biznesit të fasoneve iu falën gjrobat dhe kamatëvonesat. Në fakt gjrobat dhe kamatvonesat kanë qënë tepër të larta për këtë sektor dhe përbënin një problem serioz.

-Përmirësimet në infrastrukturë

Përmirësimet e vazhdueshme në infrastrukturë kanë patur një ndikim të ndjeshëm pozitiv në forcimin e pozitave konkurruese të këtij sektori. Përmirësimi i situatës energjetike në vend do të ndikojë në nxitjen e investitorëve, sepse më parë ky faktor përbënte pengesën më madhore. Po kështu janë lehtësuar procedurat e regjistrimit dhe të liçensimit të firmave.

Aderimi me të drejta të plota në NATO, garanton padyshim siguri në radhët e investitorëve të huaj për investimin e kapitaleve të tyre në vendin tonë.

Tabela 2.5 Avantazhet dhe disavantazhet e Shqipërisë në sektorin e fasonit	
Avantazhet	Disavantazhet
Pozita gjeografike strategjike ndikon në: -koston e ulët të transportit -logjistiken e shpejtë dhe fleksible Kostot e ulta të fuqisë punëtore Ligjet e punësimit Efektet pozitive të krizës në tërheqjen e investimeve të huaja. Treguesit e qëndrueshëm makro-ekonomikë: -rritja e qëndrueshme e GDP-së -inflacioni i ulët Politikat nxitese për të përmirësuar klimën e investimeve; -taksa mbi tatim-fitimin më e ulët në Europë -përmirësimet në infrastrukturë -heqja e taksës doganore 12.5 %	Shkalla e lartë e përqëndrimit të produkteve dhe të tregjeve të eksportit Investimet e ulta në teknologji në krahasim me standartet rajonale Disa probleme në lidhje me klimën e investimeve në drejtim të: -gjetjes së financimeve - mjedisit rregullator - kualifikimit të fuqisë punëtore

Politikat nxitese të qeverisë, rritja e angazhimit të përfaqësuesve të fasonit si dhe efektet indirekte të krizës kanë patur ndikim favorizues për industrinë e fasonit, duke rritur aftësitë konkurruese të sektorit në të ardhmen.

PJESA E TRETË

➤ STUDIMI I EFEKTEVE TË KRIZES EKONOMIKE NË RAJONIN E KORÇËS

Rajoni i Korçës është ndër më të rëndësishmit përse i përket sektorit të fasonit. Në këtë rajon janë rreth 40 firma fasoniste nga të cilat 2 firma janë për prodhimin e këpucëve, 1 për përpunimin e lëkurës dhe pjesa tjetër i përkasin konfeksioneve. Për shkak të pozitës gjeografike pjesa më e madhe e investitorëve janë grekë. Rajoni i Korçës ofron një potencial të madh për zhvillimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të këtij sektori prodhimi në të ardhmen.

Në këtë pjesë do të trajtohet ndikimi që ka pasur kriza ekonomike në firmat e fasonit në Korçë krahasuar edhe me qytete të tjera si dhe aspekti social duke u fokusuar në disa nga problemet me të cilat ndeshen punonjësit e firmave fasoniste.

3.1 .Rast studimi

Qëllimi i pyetsorit ishte të studionte efektet e krizës ekonomike në sektorin e fasonit në Rajonin e Korçës dhe aspektin social të këtij sektori.

Studimi u bazua në dy pyetsorë njëri për punëdhënësit dhe tjetri për punonjësit. Pyetsori i parë kishte në fokus ndikimin e krizës ekonomike në firmat e fasonit. Në studim u marrën 13 firma, 1 firmë këpuce dhe 12 për konfeksionete veshjeve. Pyetsori i dytë ishte për punonjësit e firmave të fasonit. Gjithsej u shpërndanë 155 pyetsorë nga të cilët 5 ishin të pavlefshëm. Pyetsorët ishin strukturuar me pyetje të hapura dhe të mbyllura , me një / disa mundësi zgjedhje.

Rezultatet e pyetsorit për firmat paraqiten si më poshtë:

A.Profili i firmave

-Viti i krijimit:

Nga 13 firma të anketuara 30.7 % ishin themeluar në periudhën 1990-1995, 30.7 % në vitet 1996-2000 dhe pjesa tjetër pas vitit 2001(Grafiku 3.1). Pra mbi 60 % e firmave kanë fituar eksperiencë dhe një përvojë mbi 10 vjeçare në këtë sektor.Firmat që ishin themeluar para vitit 2000 kishin edhe numrin më të madh të punonjësve.Firmat e themeluara pas vitit 2001 ishin të gjitha në pronësi shqiptare.

-Pronësia:

Dy firma ishin me pronësi të përbashkët greko-shqiptare,ndërsa dy firmat e tjera me pronësi të huaj,një nga Greqia dhe një nga Qiproja. Pozita gjeografike e Korçës ka bërë që investitorët të jenë kryesisht nga Greqia (grafiku 3.2).

-Madhësia e firmave bazuar në numrin e punonjësve:

15.3 % e firmave kishin nga 1-9 punonjës, 15.3 % kishin 10-25 punonjës, 23.4 % nga 26-50 punonjës , 7.6 % nga 51-80 punonjës dhe 38.4 % e firmave kishin mbi 80 punonjës. 4 nga 5 ndërmarrjet që kishin mbi 80 punëtorë ishin në pronësi të huaj ose të përbashkët (grafiku 3.3).Kjo tregon se investitorët e huaj kanë më tepër kapacitete për zgjerim se ata shqiptarë.Numrin më të madh të punonjësve e kanë firmat e krijuara para vitit 2000.

B.Ndikimi i krizës

-Periudha e fillimit të efekteve të krizës:

Pjesa më e madhe e firmave (38.7%) kanë ndjerë efektet e krizës në muajt e fundit të 2008 dhe në fillim të vitit 2009 (tabela 3.1).Edhe në nivel kombëtar efektet e krizës filluan të shfaqeshin më tepër në këtë periudhë.Në këtë kohë edhe tregjet europiane ishin në vështirësi.

-Shitjet në 2009 krahasuar me 2008:

Gjatë vitit 2009 shitjet janë ulur në 5 firma , në 4 firma shitjet nuk kanë ndryshuar dhe në 4 të tjera ka patur rritje(grafiku 3.4). Sipas studimit të ACIT nga 15 firmat e marra në studim në

Korçë ,në 6 firma ka patur ulje të shitjeve, në 5 firma shitjet nuk kanë ndryshuar dhe në 4 të tjera shitjet janë rritur.

Në qoftë se do ta krahasonim Korçën me dy qytetet e tjera të marra nëstudim , duket se kriza ka patur më pak efekte negative për kompanitë në krahasim me qytetet e Shkodrës dhe të Tiranës, pavarësisht nga lidhja me tregun grek(grafiku 3.5). Në këtë situatë ka ndikuar fakti që për firmat në Korçë nuk ka patur anulime të kontratave siç ka ndodhur në qytetet e Shkodrës, Tiranës apo Durrësit. Këto qytete në ndryshim nga Korça kanë më tepër lidhje me tregun italian.

-Shitjet në 2010 krahasuar me 2009:

Gjatë vitit 2010 niveli i shitjeve ka qënë më i ulët se 2009. (grafiku 3.6). 6 firma kanë patur rënie të shitjeve, 4 nuk kanë patur ndryshim dhe 3 kanë patur rritje në shitje.Edhe deklaratat e eksportit të Drejtorisë së Doganave në Korçë tregojnë për një nivel më të ulët të shitjeve në 2010 krahasuar me 2009 (grafiku 3.8). Në 3 mujorin e parë të 2010 në krahasim me 3 mujorin e parë 2009 ka patur më tepër rënie të shitjeve në Korçë ku nga 15 firma 8 kanë raportuar ulje te shitjeve, ndërsa firmat në Tiranë dhe Shkodër nuk kanë ndonjë ndryshim në krahasim me 2009.

-Shitjet në tremujorin e parë 2011 krahasuar me tremujorin e parë 2010.

61.53 % e firmave kanë patur rënie të shitjeve në 3-mujorin e parë të 2011 krahasuar me të njëjtën periudhë të 2010 (grafiku 3.7). Të pyetur nëse situata politike ka ndikuar në këtë periudhë, drejtuesit e firmave janë shprehur së nuk ka patur asnjë ndikim. Por vonesat në pagesa nga ana e porositësve vazhdojnë të jenë problem shqetësues.

-Shkaqet e rënies së shitjeve:

Shkaku kryesor i rënies së shitjeve për 62.23 % të firmave në Korçë është rënia e kërkesës në tregjet e eksportit që shoqërohet edhe me shkakun e dytë, mungesën e likuiditetit. Vetëm 1 firmë ka patur problem mosrespektimin e kontratave nga firma porositëse. Pakësimi i furnizimit me lëndë të parë ka qënë problem vetëm për 15.38 % të firmave dhe kryesisht firmat e vogla.(tabela 3.2).Edhe në nivel kombëtar, rënia e kërkesës ka qënë faktori kryesor për 71% të firmave.Përsa i përket faktoreve që kanë ndikuar në krizë ka ndryshime midis rajoneve.

Firmat në Korçë nuk kanë patur anullim të kontratave nga partnerët e huaj dhe pakësimi i furnizimit me lëndë të parë nuk ka qënë problematik. Në ndryshim firmat që operojnë në Tiranë dhe në Shkodër kanë patur anullim të kontratave nga ana e kontraktuesve sidomos atyre italianë.

Rreth 50 % e firmave në Tiranë kanë patur rënie të furnizimit me lëndë të parë, ndërsa për firmat në Korçë dhe në Shkodër ky faktor nuk përbënte një problem të ndjeshëm.

Në nivel kombëtar vetëm 28 % e firmave e shikonin likuiditetin si problematik, pra ky faktor nuk ka patur shumë ndikim. Në ndryshim për rajonin e Korçës likuiditeti ka patur dhe vazhdon të ketë ndikim të ndjeshëm. Kompanitë si në Korçë dhe në qytetet e tjera nuk e shohin konkurrencën vendore dhe atë rajonale si problematike.

Në 6-mujorin e dytë të 2011 rreth 30.77 % e firmave presin një rritje të shitjeve, 53.85 % shprehen për mosndryshim të nivelit të shitjeve dhe 15.38 % e firmave rënie të tyre. Pritshmëritë e firmave për nivelin e shitjeve reflektojnë që kriza është akoma prezente.

Performanca financiare

Gjatë vitit 2009, 30.77 % e firmave kanë patur një rënie të fitimeve që ka ardhur si rezultat i rënies së shitjeve dhe të rritjes së kostos së prodhimit nga rritja e pagës minimale. 38.46 % e firmave që kanë patur rritje të shitjeve gjatë vitit 2009 kanë patur edhe rritje të fitimeve krahasuar me 2008. Ndërsa për 30.77 % të kompanive fitimi nuk ka ndryshuar. Asnjë firmë nuk ka patur rezultat financiar negativ. Edhe gjatë vitit 2010 paraqitet përafërsisht e njëjta situatë ku 38.46 % e firmave kanë patur përmirësime të fitimeve, për 38.46% nuk ka ndryshuar dhe 23.08 % kanë ulje (grafiku 3.9). Rritjet e kostove të prodhimit si të çmimit të energjisë elektrike, karburantit dhe pagës minimale kanë patur më tepër ndikim në performancën financiare në Tiranë dhe sidomos në Shkodër sesa në Korçë¹¹.

Gjatë tre mujorit të parë të 2011 situata paraqitet më pesimiste përse i përket fitimeve, sepse 53.86 % e firmave janë shprehur se fitimet kanë qënë më të ulta krahasuar me 3- mujorin e parë të vitit 2010 (grafiku 3.10). Rënia e shitjeve ka ndikuar në nivelin e ulët të fitimeve.

¹¹ ACIT: "Social Dimensions of the Global Crisis in Albania. The Fason Industry as a Case Study". Qershor 2010

Punësimi

-Punësimi në 2011 krahasuar me 2010 :

Gjatë vitit 2011 nga 13 firma të anketuara vetëm 2 prej tyre kanë ulur numrin e punonjësve, 6 firma nuk ka patur ndryshim dhe në 5 prej tyre numri i punonjësve është rritur (grafiku 3.11).

Edhe përse i përket punësimit ka patur tregues të ndryshëm midis qyteteve. Reduktimi i numrit të punonjësve ka qënë më i madh në qytetet e Shkodrës, Tiranës, Durrësit sesa në Korçë. Nga 15 firma në Korçë vetem 1 ka reduktuar punësimin, në Shkodër nga 19 firma 5 kanë ulur punësimin dhe në Tiranë kjo ka qënë më e ndryshme ku 9 nga 27 firma të përgjigjura kanë ulur numrin e punonjësve në 2009 (grafiku 3.12)

-Punësimi në 2010 krahasuar me 2009:

Gjatë vitit 2010 ka patur më tepër firma që kanë ulur numrin e punonjësve në qytetin e Korçës. 5 nga 13 kompanitë e pyetura kanë ulur numrin e punonjësve dhe 3 firma kanë rritur numrin e tyre (grafiku 3.13).

Në 3 mujin e parë të 2010, 4 nga 15 firmat e anketuara në Korçë kishin ulur numrin e punonjësve, ndërsa në 6 prej tyre kishte rritje. Në qytetet e tjera ka patur më tepër firma që kanë ulur numrin e punonjësve (tabela 3.3). Kjo tregon që në këto qytete kriza ka patur ndikim më të madh se në Korçë.

Tabela 3.4 Masat e marra nga firmat për përballimin e krizës	
Kërkimi i tregjeve të reja të shitjes së produkteve	
Bashkëpunim me kompani të huaja	
Përmirësim i cilësisë së produkteve	
Kërkesë për kredi nga sistemi bankar	
Shtyrje të pagave të punonjësve dhe të detyrimeve të ndryshme ndaj administratës tatimore	
Reduktim numrit të punonjësve	
Shtim i linjave të prodhimit duke kaluar nga forma fasoni i pastër në formën e prodhimit për eksport me materialet e para dhe lendë ndihmëse të blera dhe përpunuara nga vetë firma.	
Investime në teknologji të reja	

Tabela 3.5 Mbeshtetje që firmat fasoniste kërkojnë nga shteti	
Lehtësira që firmat kërkojnë nga qeveria	Në %
Mbeshtetje në marketing sidomos atë ndërkombëtar	46.5
Lehtësira fiskale	46.15
Mbeshtetje në kreditim	30.76
Mbeshtetje për kualifikim profesional	30.76

Rezultatet e pyetsorit për punonjësit

-Grupmosha ;

Numrin më të madh të punonjësve të anketuar, rreth 39 % e përbënte grupmosha 36-45 vjeç dhe 21 % grupmosha 26-35 vjeç. 7 % e punonjësve ishin nën moshën 18 vjeç, kështu punëdhënësit shkelin legjislacionin për ndalimin e punësimit të minoreneve (grafiku 3.14). Në fakt sektori i fasonit ka njënumër të madh të punonjësve nën moshë. Rreth 60% e punonjësve kishin më tepër se 5 vjet punë në firmë, duke treguar për një qëndrueshmëri të forcës punëtore.

-Arsimi:

6 % e të anktuarve ishin me arsim fillor, 42 % me 8-vjeçar, 48 % me arsim të mesëm, dhe vetëm 4 % me arsim të lartë (grafiku 3.15). Pra siç shihet ky sektor tërheq një numër të madh të punonjësve me kualifikim minimal.

Krahasuar edhe me studimin e ACIT, rezultatet janë të njëjta, punëtorët në industrinë e fasonit kanë kualifikim shumë të ulët. Nga 225 punonjës të pyetur 24.8 % ishte me arsim fillor, 8.2 % arsim 8-vjeçar, 37.6 % arsimin e mesëm, 23 % arsimin e mesëm profesional dhe vetëm 12.7 % arsimin e lartë.

-Sigurimi i punonjesve:

Anketa tregoi se një numër i madh punonjësish (32 %) ishin të pasiguruar duke treguar edhe në këtë drejtim shkeljen e Kodit të Punës nga ana e punëdhënësve (grafiku 3.16). Të gjithë punonjësit nën moshën 18 vjeç dhe punonjësit në fasonet e vogla me më pak se 10 punonjës ishin të pasiguruar. Shpesh firmat për të mos siguruar punonjësit i nxjerrin në asistencë kryesisht ata të komunitetit rom.

-Kontratat e punës:

Të gjithë punonjësit e pasiguruar nuk kishin kontrata (grafiku 3.17). Për personat e siguruar dhe me kontrata, punëdhënësit preferojnë më tepër kontratat 1 vjeçare që përsëriten (grafiku 3.18). Punonjësit me kontrata mbi 1 vit ishin ata në postet më të rëndësishme si ekonomistët, përgjegjësit dhe specialistët të tjerë.

-Paga mujore:

Më tepër se 45 % e punonjësve paguheshin me pagë nën minimalen pra më pak se 19 000 nga të cilët, 19 % e tyre kishin një pagë deri në 15 000 lek, 42 % e punonjësve kishin paga midis 19 000-25 000 lek dhe vetëm 13 % e tyre kishin paga mbi 25 000 lek (grafiku 3.19). Edhe në këtë aspekt del qartë abuzimi që bëhet me punonjësit e këtij sektori duke treguar se në Shqipëri industrinë e konfeksioneve dhe këpucëve kanë pagat më të ulta për punonjësit dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre paguhen me paga nën minimalen.

-Afati i marrjes së pagave:

Rreth 35 % e punonjësve kanë patur vonesa në marrjen e pages (grafiku 3.20). Por këto vonesa nuk varen nga firma por vinë si rezultat i mungesës së likuiditetit nga firmat porositëse.

-Puna me orar të zgjatur dhe pagesa për orët shtesë:

46 % e punonjësve punonin më orar të zgjatur (grafiku 3.21).

Pagesa për orët shtesë si dhe pagat në rastet e diteve të festave dhe diteve pushim është më tepër sa paga për 8 orë, duke reflektuar përsëri mosrespektimin e legjislacionit nga ana e punëdhënësve. 67 % e punonjësve për orët shtesë paguheshin sa 8-orarshi dhe vetëm 33 % e tyre paguheshin me 125 %. Asnjë punonjës nuk paguhej me 150 % për punë në ditët pushim dhe në rast festash (grafiku 3.22).

-Vlerësimi i kushteve të punës:

18 % e punonjësve i vlerësonin kushtet e punës shumë të mira, 66 % e tyre i vlerësonin në një nivel mesatar dhe 14 % si të këqija (grafiku 3.23).

-Përmirësime që kërkonin punonjësit:

Rritje të pagave

Ulje të normave të prodhimit

Përmirësim të kushteve të punës si tënëgrohjes ,ndriçimit,pastërti të ambjentit, reduktim të zhurmave,sigurim të transportit.

3.2.Perspektiva e industrisë së fasonit në të ardhmen

-Rritja e interesit të investitorëve europianë

Interesi i investitorëve europianë për të përqëndruar investimet në Ballkanin Perëndimor po vjen gjithnjë e në rritje pas krizës ekonomike.Shtetet e BE-së po i shohin vendet e vogla të rajonit të Ballkanit si një “Kinë” e vogël për industrinë e veshjeve dhe këpucëve. Në këtë kuadër Shoqata Europiane e Tekstileve“Eurotex” ka filluar një projekt nën vëzhgimin e Komisionit Europian që përfshihen pesë shtete të rajonit të Ballkanit Perëndimor mes të cilëve edhe Shqipëria.Qëllimi i këtij projekti është të ndihmojë sektorin e veshjeve, të integrohet në zinxhirin e përgjithshëm të vlerave të industrisë europiane.

Industria e konfeksioneve dhe e këpucëve në Shqipëri është konsideruar tashmë, edhe nga analistët ndërkombëtarë, si mundësi reale për të zhvilluar kapacitete prodhuese me orientim drejt tregjeve ndërkombëtare.Në një vorbull të dyfishtë efektsh të krizës, mundësitë e tregut shqiptar (në tërësi të Ballkanit Perëndimor) janë për më shumë porosi dhe investime në teknologji nga sipërmarrësit e Europës Perëndimore.

Avantazhet konkurruese shtojnë mundësitë për më shumë investime dhe mundësi reale për krijimin e ndërmarjeve të përbashkëta midis sipërmarrësve të huaj dhe atyre shqiptarë. Përmirësimi i klimës së biznesit në përgjithësi, ulja e barrës tatimore, përmirësimet në infrastrukturë janë faktorë të rëndësishëm për mbështetjen e këtyre avantazheve dhe kjo e kombinuar me rritjen e cilesisë së manaxhimit dhe aftësive njerzore për një performancë më efikase të biznesit fasonist, synon të sjellë rezultate pozitive.

Një mundësi e madhe për sektorin e fasonit është edhe një vendim i marrë nga BE i cilësuar si kumulimi trigonal Turqi-Shqipëri-BE. Ky vendim favorizues lejon që produktet e fasonit të veshjeve që prodhohen në Shqipëri dhe kanë si destinacion tregun europian, zhvishen nga taksat doganore në qoftë se lënda e parë që përdoret për prodhimin e tyre vjen nga një vend i komunitetit europian.Po kështu BE ka vendosur edhe një tarifë 20 % për këpucët e eksportuara nga vendet aziatike.

-Tregjet e reja

Hapja e tregjeve dhe heqja e barrierave doganore shtron mundësi të mëdha për të ardhmen e kësaj industrie. Holanda, Franca, Gjermania, Spanja, Zvicra, janë disa nga tregjet që po tregojnë

më shumë interes nga fasonistët. Çmimet e shitjes së produkteve në këto vende janë më të larta se ato në Itali dhe Greqi, me të cilat është kryer pjesa dërrmuese e eksporteve deri tani. Kjo do të thotë se çmimet që iu ofrojnë firmat shqiptare këtyre tregjeve të reja, të huajve iu duken shumë të leverdishme dhe rrjedhimisht, kanë interes për të bashkëpunuar me tregun shqiptar. Kriza ndihmoi biznesin vendas që të kërkojë tregje të reja përtej atyre tradicionale dhe të rrisë shanset që në një periudhë më të qetë ekonomike të ketë rritje cilësore të eksporteve.

-Projektet për të ardhmen

Dhoma e Fasonistëve të Shqipërisë është tashmë e angazhuar në zhvillimin e një studimi analitik për shanset dhe kapacitetet që ka sektori fason. Qëllimi kryesor i këtij studimi analitik është ndërtimi i një programi strategjik kombëtar, që do të mbledhë një sërë instrumentesh operacionale, projekte teknike dhe fonde financiare në formën e një përfaqëse të integruar në funksion të modernizimit teknologjik, inovacionit, rritjen e kapaciteteve dhe aksesin e tregjeve të eksportit. Në bashkëpunim me METE, me agjenci të specializuara të investimeve të biznesit dhe me një sërë konsulentësh të identifikuar tashmë, Dhoma e Fasonistëve po ndërmjetëson për hapat konkrete të zhvillimit e realizimit të këtij programi¹².

Në mënyrë që kjo lëvizje strategjike të ketë premisat e saj fizike dhe financiare, Dhoma po punon për krijimin e një zone industriale pilot në Tiranë, ku do të përqendrohen kompanitë më të rëndësishme, infrastruktura e shërbimeve, laboratorë modernë, si dhe një qendër koordinimi, marketingu e informacioni kombëtar e ndërkombëtar. Në këtë mënyrë do të bëhet përputhja e këtij kapaciteti të koordinuar e të integruar me kapitalin ndërkombëtar dhe me tregjet e produkteve. Disa kompani të mëdha të fasonit e pranojnë rëndësinë e zhvillimit të markës së tyre, e cila do të krijonte më shumë mundësi për eksportin direkt drejt një klientele të larmishme se sa thjesht të ri-eksportoje drejt tregjeve të huaja. Interes në rritje po tregohet edhe nga Gjermania. Në përgjithësi industria gjermane e veshjeve e sheh Shqipërinë si vend prodhimi, si një alternativë të rëndësishme dhe të aftë për zhvillim në 5 deri 10 vitet e ardhshme për t'u futur në rrjetin e firmave të fasonit të përqëndruar në Evropën Qëndrore dhe Juglindore. Një kompani logjistike gjermane, është angazhuar për të punuar me sipërmarrjet e grupuara shqiptare të veshjeve në krijimin e parkut industrial. Ndihmësë të madhe në këtë drejtim po jep edhe GTZ.

Krijimi i një parku industrial për sektorin e veshjeve, nuk shman punën në rajonet e tjera, pasi sipërmarrjet do të zhvillojnë një aktivitet të ri dhe për më tepër do të delegojnë një pjesë të punës nëpër rajon. Kështu sipërmarrjet duhet të koordinojnë punën, të vendosura në një zonë të përbashkët industriale, ku të gjitha së bashku të plotësojnë kërkesat e plota të një kompanie të madhe. Krijimi i këtij blloku mendohet të hap rreth 20 mijë vende pune në 5 vitet e ardhshme.

Për të përfituar nga këto mundësi është e rëndësishme standartizimi i produkteve. Harta e tregut të eksporteve nuk mund të zgjerohet dhe diversifikohet pa garantuar standardin. Sipas

¹² INFOARKIV: Kryetari i Dhomës së Fasonistëve, artikulli “Drejt një industrie më autonome”

përfaqësuesvetë DHKPVK tashmë nuk është vetëm nevojë, por domosdoshmëri që produktet shqiptare të kenë standardet evropiane. Kjo vjen dhe nga trendi i një tregu të hapur dhe global në kushtet kur Shqipëria ka nënshkruar marrëveshjet e tregtisë së lire. Kjo rrit konkurrueshmërinë për prodhimet dhe shërbimet e kësaj industrie.

Për sektorin e fasonit, ka nisur në shkallë të gjerë vitet e fundit të bëhet standardizimi i produkteve të tyre sipas standardit ISO 9001, apo dhe me standarde të tjera të njohura ndërkombëtare në varësi të destinacionit dhe kërkesave që ka konsumatori. Kohët e fundit një studio gjermane ka bërë një studim për nivelin e produkteve dhe shërbimeve që ofrohet nga firmat shqipëtare të fasonëve. Sipas këtij studimi rreth një e treta e kompanive të vëzhguara janë të gatshme të hyjnë që sot në tregun evropian, sepse i plotësojnë kushtet. Një e treta e këtyre kompanive janë të gatshme që me përmirësime operacionale dhe disa investime të vogla teknologjike mund të jenë shumë shpejt pjesë e tregut evropian dhe më gjerë. dhe vetëm një e treta prej tyre kanë probleme, që lidhen me investimet apo me diversifikimin e proceseve dhe produkteve që realizojnë.

Siç shihet oportunitetet për tu zhvilluar në të ardhmen janë të shumta. Mbetet vetëm që firmat shqiptare të kapin ritmin e tregut dhe të shfrytëzojnë siç duhet këto mundësi.

KONKLUSIONE

Sektori i fasonit ka patur një rritje dhe zhvillim të konsiderueshëm pas viteve 2000, duke u shëndruar në një nga sektorët më të rëndësishëm ekonomik në drejtim të tërheqjes së investitorëve të huaj, forcimit të aftësive thithëse teknologjike të firmave dhe në peshën kryesore që zë në eksportet totale. Rëndësia e sektorit shfaqet edhe në aspektin social në drejtim të punësimit.

Efektet e krizës globale u ndjenë edhe në Shqipëri megjithëse në nivel më të moderuar. Sektori më i prekur nga kriza ekonomike ishte fasoni duke reflektuar varësinë e madhe të këtij sektori ndaj tregut të jashtëm. Kriza në këtë sektor që u ndje më tepër në vitin 2009 u shoqërua me një sërë efektesh zhinxhir si rrënia e eksporteve, ulja e prodhueshmërisë, fitimeve dhe aftësisë konkurruese të firmave, rritje e papunësisë, thellim i defiçitit tregëtar.

Krahas krizës ekonomike edhe disa reforma qeveritare si rritja e pagave minimale dhe vendosja e pagave referuese, rritja e çmimit të energjisë, akcizës dhe problemet me rimbursimin e TVSH-së, kanë vënë në vështirësi këtë industri dhe potencialin konkurrues të saj.

Kriza ekonomike krahas efekteve direkte negative ka patur edhe efekte indirekte që kanë ndikuar pozitivisht në konkurrueshmërinë e sektorit. Bizneset fasoniste kanë rritur më tepër angazhimin e tyre dhe qeveria duke parë rëndësinë e sektorit në ekonomi ka marrë një sërë reformash për favorizimin e sektorit duke ritur interesin e investitorëve të huaj. Shqipëria krahas disa problemeve, ofron avantazhe të shumta për investitorët në krahasim me vende të tjera si, kostoja e ulët e fuqisë punëtore, pozita gjeografike, ligjet e punësimit dhe treguesit e qëndrueshëm ekonomikë.

Rezultati i studimit tregoi se edhe në rajonin e Korçës biznesi fasonist ka ndjerë efektet e krizës, duke patur rënie të shitjeve dhe të rezultatit financiar gjatë vitëve 2009-2010 dhe shkaku kryesor ka qënë rënia e kërkesës në tregjet e eksportit dhe mungesa e likuiditetit. Por kriza ka patur më pak efekte negative në qytetin e Korçës në krahasim me qytetet e tjera si Durrsësi, Shkodra dhe Tirana.

Rezultatet e pyetsorit të punonjësve reflektojnë një sërë abuzimesh të punëdhënësve me fuqinë punëtore. Shkeljet e Kodit të Punës në lidhje me mosrespektimin e ligjit për pagat minimale, punësimin e të miturve, sigurimit të punonjësve, oraret e zgjatura të punës dhe mospagesa e duhur për orët shtesë tregojnë se ky është një ndër sektorët më problematikë në këto drejtime në gjithë vendin.

Me avantazhet që ofron Shqipëria dhe interesit në rritje të investitorëve, perspektiva e sektorit të fasonit për të patur një nivel të lartë zhvillimi dhe për të konkurruar në tregun e huaj është e madhe. Kjo industri, me avancimet e saj, me fuqizimin, forcimin e zhvillimin e kapaciteteve

menaxheriale të vendit, me shfrytëzimin e përvojës së fituar ndër vite, po shndërrohet gjithnjë e më shumë në një industri më autonome, pra në eksportimin e produkteve “Made in Albania”.

Dhe pikerisht ky zhvillim po vihej re pas periudhës së krizës së vitit 2008, në vendet në zhvillim, sikundër dhe në Shqipëri, biznesi fason nisi të zgjrohej më tepër. Kjo për shkak edhe sepse shumë fabrika i zhvendosën linjat e tyre të prodhimit pikërisht në vendet ku kostot ishin më të ulëta.

Vitet e fundit , kjo industri po e bënte Shqipërinë një nga vendet më të lakmuara nga investitorët e huaj. Firmat e huaja që synonin të shtrijnë aktivitetin e tyre në vendin tonë ishin gjithmonë në rritje. Përveç kompanive italiane dhe greke, kishte interesim edhe nga ato gjermane, holandeze, norvegjeze etj. Vihej re gjithashtu një diversifikim në drejtime të reja të fasonit në Shqipëri. Njëlloj si funksionin dikur fasoni i tekstileve dhe këpucëve, sot kemi të bëjmë edhe me linja montimi të pajisjeve të ndryshme industriale, elektrike dhe elektronike. Madje sipas studimeve të fundit të INSTAT duket se eksportet nga fasoni industrial u dyfishuan krahasuar me ato të tekstit apo këpucëve.

Por atëherë kur dukej se ky biznes ishte në kulmin e tij, disa faktorë si rritja e taksave, rritja e cmimit të energjisë etj, e vuri sërish në presion biznesin fason duke ndikuar negativisht dhe duke sjellë sërish një rënie të eksporteve në të gjitha drejtimet e kësaj industrie, pavarësisht propagandës së bërë nga ana e instancave qeveritare. Sipas aktorëve të tregut kjo rritje e reklamuar fasoniste, është vetëm një fasadë, pasi kostot e rritura po nxisin informalitetin.

Në të njëjtën linjë ka qenë dhe Dhoma Amerikane, e cila në kërkesën drejtuar Ministrisë së Financave për paketën fiskale 2016 ka pohuar se *“u mendua për FASON-istët se do të kishte lehtësira fiskale, por kjo nuk ndodhi, përkundrazi ndodhën ndryshime që e rënduan gjendjen e tyre. Rritja e çmimit të energjisë ka shkaktuar problematika për këtë sektor dhe ne propozojmë që TVSH-ja për energjinë të ulet nga 20 në 6 për qind. Ndërkaq, jo vetëm sektori i fasonit, por shumë industri janë duke e ndjerë rritjen e çmimit të karburantit. Ne propozojmë një reduktim të normës së taksës së qarkullimit dhe asaj të karbonit për karburantin”*.

Një faktor tjetër që është vënë re kohët e fundit dhe që ka sjellë dobësimin e fasonit është edhe niveli i lartë i kriminalizimit në vend.

Në përfundim të këtij studimi, duke bërë një krahasim të ecurisë së biznesit fason ndër vite në Shqipëri, duke vënë përballë zhvillimet dhe pengesat, avantazhet dhe disavantazhet e tij që shpesh vihet re të kalojnë njëri-tjetrin, mund të themi se është industria që ka pësuar më tepër luhatje gjatë gjithë rrugëtimit të tij, dhe duket se me klimën aktuale politike ekonomike dhe sociale, do të vazhdojë kështu shumë gjatë.

REKOMANDIME

Për qeverinë;

Qeveria duhet të jetë një partner kryesor i sektorit të fasonit në disa aspekte si:

Mbështetje në marketing ndërkombëtar në mënyrë aktive në gjetjen e tregjeve të reja.

Reformim i sistemit të pagesës së kontributeve shoqërore, duke u llogaritur mbi pagën faktike dhe jo atë referuese.

Të ofrojë më tepër ndihmë në lidhjen e kontratave dhe respektimin e tyre nga investitorët e huaj.

Mbështetje nëpërmjet programeve në kualifikimin dhe formimin profesional të punonjësve.

Të ofrojë lehtësira fiskale si: heqja e taksës mbi tatim-fitimin, zgjedhja e problemeve të rimbursimit të TVSH-së

Të ofrojë nxitje mbi punësimin nëpërmjet lehtësirave në sigurimet e punonjësve të rinj.

Krijimin e grave dhe fondeve për të nxitur investimet në inovacione dhe teknologji.

Të mbështesë firmat në gjetjen e instrumentave financiare si nga burime vendase dhe të huaja dhe të lehtësojë kreditimin e këtij sektori.

Për firmat fasoniste:

Të investojnë në trajnimin e fuqisë punëtore dhe në zhvillimin e aftësive menaxheriale.

Të përmirësojnë dhe investojnë në teknologji të avancuar për të rritur kapacitetet dhe efikasitetin e prodhimit duke përmirësuar produktivitetin.

Të ndryshojnë orientim, nga biznese të orientuara drejt prodhimit në biznese të orientuara nga tregu.

Të rrisin prezencën në tregun e brendshëm duke konkurruar produktet e importit.

Për ato firma që duan të bëhen pjesë e tregut europian me produkte shqiptare obsionet që mund të ndjekin janë:

-Të krijojnë markën shqiptare dhe zhvillojnë një marketing agresiv;

-Të bashkëpunojnë me kompanitë më të mëdha ndërkombëtare, për të siguruar kontrata prodhimi me cikël të plotë, për produkte “Made in Albania”.

-Të përmirësojnë cilësinë e produkteve dhe të çertifikojnë standartet e cilësisë, që është shumë e rëndësishme për investitorët europianë.

Dhoma e Tregëtisë të rrisë angazhimin dhe bashkëpunimin me Qeverinë për një përfaqësim më të mirë të interesave të biznest të fasonit.

Për sindikatat dhe ISHP:

Rritja e prezencës së sindikatave në vendin e punës dhe forcimi i kapaciteteve të tyre me qëllim që punonjësve t’ju sigurohet një mbrojtje reale e të drejtave në ambjentin e punës.

Forcimi i kontrollit nga ana e Inspektoriatit Shtetëror të Punës (ISHP), duke rritur ndërgjegjësimin për ato subjekte që nuk respektojnë Kodin e Punës.

ANEKS

PYETSORI

Qëllimi i pyetsorit:të studiojë ndikimin dhe efektet e krizës ekonomike në sektorin e fasonit në rajonin e Korçës.

A.Profili i kompanisë

1.Viti i krijimit të kompanisë()

2.Pronësia e kompanisë;

pronarë vendas
pronarë të huaj
pronësi e përbashkët

Nese kompania ka pronarë të huaj nga cili shtet janë ata?()

3.Madhesia e kompanive bazuar në numrin e punonjesve:

1-10 punonjes
11-25 punonjes
26-50 punonjes
51-80 punonjes
Mbi 80 punonjes

B.Ndikimi i krizës ekonomike

4.Kur keni filluar të ndjeni efektet e krizes:

Tre mujori i tretë 2008
Tre mujori i katërt 2008
Tremujori i parë 2009
Tjetër. Specifiko ()

5.Shitjet gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008 janë:

Ulur
Nuk kanë ndryshuar
Janë rritur

6. Shitjet gjatë vitit 2010 në krahasim me vitin 2009 janë :

Ulur
Nuk kanë ndryshuar
Janë rritur

7. Shitjet në 3 mujorin e parë 2011 në krahasim me tremujorin e parë 2010 janë :

Ulur
Nuk kanë ndryshuar
Janë rritur

8. Shkaqet e pakësimit tëshitjeve :

Pakësimi i furnizimit me lëndë të parë apo materiale të tjera të nevojshme nga kompania porositëse
Mungesa e likuiditetit nga kompanitë porositëse
Mosrespektimi apo anulimi i kontratave nga kompanitë porositëse
Rënia e kërkeses në tregjet e eksportit
Rritja e konkurrencës në vend
Rritja e konkurrencës në rajon
Rritja e kostove të prodhimit
Tjetër. Specifiko ()

9. Rezultati financiar (fitimi) gjatë 2010 në krahasim me 2009 është:

Përmirësuar
Nuk ka ndryshuar
Ka pasur rënie
Rezultati financiar ka qënë negativ

10. Rezultati financiar gjatë tremujorit të parë të 2011 në krahasim me 2010 është:

Përmirësuar
Nuk ka ndryshuar
Ka pasur rënie
Rezultati financiar ka qënë negativ

11. Gjate gjashtëmujorit të dytë të 2011 prisni qëshitjet :

Të rriten
Të mos ndryshojnë
Të ulen

12.Numri i punonjësve me kohë të plotë gjatë 2009 në krahasim me 2008 është:

Ritur
Nuk ka ndryshuar
Është ulur

13.Numri i punonjesve me kohë të plotë gjatë 2010 në krahasim me 2009 është:

Ritur
Nuk ka ndryshuar
Është ulur

14.Çfarë masash keni marrë për të përballuar situatën;

Keni kërkuar tregje të reja të shitjes së produktit
Keni kërkuar bashkëpunim me kompani të huaja
Keni përmiresuar cilesinë e produktit dhe marketingun e tij
Keni kërkuar kredi nga sistemi banker
Masa te tjera ()

15.Çfarë mbështetje do të kërkonit nga qeveria:

Mbështetje në marketing sidomos atë ndërkombetar
Mbështetje për kualifikim profesional
Mbështetje fiskale
Mbështetje në kreditim
Lehtësira të tjera ()

PYETSOR

Pyetsori për punonjësit e firmave të fasonit

1.Mosha:

Më pak se 18 vjeç
18-25 vjec
26-35 vjec
36-45 vjec
Mbi 45 vjec

2.Arsimi:

- Fillor
- 8-vjeçar
- I mesëm i përgjithshëm
- I mesem profesional
- I lartë

3.Titulli i punës që keni në firmë()

4.Sa kohë keni që punoni në këtë firmë?()

5.Jeni të siguruar?

- Po
- Jo

6.Keni kontrata pune?

- Po
- Jo

7.Në rast se keni kontrata , sa është afati kohor i tyre :

- 3 muaj-6 muaj
- 6muaj-1 vit
- 1vit – 2 vjet
- Me tepër se dy vjet

8.Paga mujore:

- Deri ne 15000 lek
- Mbi 15 000-më pak se 19 000 lek
- Mbi 19 000-25000 lek
- Mbi 25000- 30000 lek
- Mbi 30 000 lek

9.Pagën e merrni brenda afatit të caktuar?

- Po
- Jo

10.Punoni me orar te zgjatur?

- Po
- Jo

11.Në rast se punoni me orar të zgjatur si paguheni për orët shtesë?

12.Në rast se punoni në ditet e festave dhe në ditët pushim si paguheni ;

Sa 8- orarshi

Me 125 %

Me 150 %

13.Cfarë përmiresimesh do të kërkonit nga firma juaj?

Rritje të pagave

Ulje të normave të prodhimit

Përmirësim të kushteve të punës

TERMINOLOGJIA

ACIT	Qendra Shqipëtare për Tregëtinë dhe Konkurrueshmërinë
B-H	Bosnja Hercegovina
CEFTA	Marëveshja e Tregëtisë së Lirë e Europës Qëndrore (Shqipëri, Maqedoni, Kosova, Mali i Zi, Serbi, Kroaci, Bosnja-Hercegovina, Moldavi)
EFTA	Shoqata Europiane e Tregëtisë së Lirë (Zvicra, Lihtenshtejni, Norvegjia Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
SME	Banka Botërore
BB	Organizata Botërore e Tregëtisë
OBT	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FMN	Cut-and-Make

CM	Cut-Make-Trim
CMT	Original Brand Manufacturer
OBM	Original Equipment Manufacturer
OEM	Instituti i Statistikave
INSTAT	Instituti European i Statistikave
EUROSTAT	Sistemi Modular i Prodhimit
MPS	Tregëtia për Procesim të Huaj
OPT	Agjensia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve
AIDA	Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
USAID	Sistemi i Automatizuar për të Dhënat Doganore
ASYCUDIA	Aleanca Ushtarake e Atlantikut Verior
NATO	
DHKPVK	Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve dhe Këpucëve
FYROM	Maqedonia
GTZ	Organizata Gjermane për Bashkepunim Teknik
HDI	Investimet e Huaja Direkte
ICS	Sondazh për Klimën e Investimeve
ISO 9001	Standartet për Menaxhimin e Cilësisë
METE	Ministria e Ekonomisë Tregëtisë dhe Energjitikës
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
QKZH	Qendra për Kërkim dhe Zhvillim
UPC	Kodi Uniform i Produktit
GDP	Produkti i Brendshëm Bruto
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
NOA	Agjensia Kombëtare e Lajmeve
INFOARKIV	Arkiva Mediatike Shqiptare

Tabelat

Tabela 2.1 Eksportet e përpunimit aktiv sipas dy sektorëve

Tabela 2.2 Përqëndrimi i eksporteve sipas produkteve dhe zonës gjeografike 1999-2007

Tabela 2.3 Treguesit makroekonomikë të Shqipërisë në tregëti

Grafikët

.....
Grafiku 1.1 Peshat në % të dy sektorëve (konfeksione+këpucë) ndaj eksporteve dhe importeve totale

Grafiku 2.1 Zbatimi i simboleve të standarteve UPC

Grafiku 2.3 Zhvillimi i linjave të reja të produkteve

Grafiku 2.4 Paga minimale mujore në Shqipëri dhe në disa vende të tjera konkurruese, 2012

Grafikët

Grafiku 3.1 Viti i krijimit të firmave

Grafiku 3.2 Pronësia e firmave

Grafiku 3.3 Madhësia e firmave bazuar në numrin e punonjësve

Grafiku 3.4 Shitjet në 2010 në krahasim me 2009

Grafiku 3.5 Shitjet në 2011 në krahasim me 2010sipas ACIT

Grafiku 3.6 Shitjet në 2012 në krahasim me 2011

Grafiku 3.7 Shitjet në 3-mujorin e parë 2012 në krahasim me 3-mujorin e parë 2011

Grafiku 3.8 Deklaratat e eksportit për çdo 3-mujor, 2007- 3-mujori i parë 2011 në rajonin e Korçës

Grafiku 3.9 Rezultati financiar(fitimi) në 2010/ 2009 dhe në 2011/ 2010

Grafiku 3.10 Rezultati financiar në 3-mujorin e parë 2011 në krahasim me 3-mujorin e parë 2010

Grafiku 3.11 Numri i punonjësve me kohë të plotë në 2009/2008

Grafiku 3.12 Numri i punonjësve me kohë të plotë në 2011/2010sipas ACIT

Grafiku 3.13 Numri i punonjësve me kohë të plotë në 2012/ 2011

Grafiku 3.14 Grupmoshat e punonjësve

Grafiku 3.15 Arsimi i punonjësve

Grafiku 3.16 Sigurimi i punonjësve

Grafiku 3.17 Kontratat e punës

Grafiku 3.18 Afati i kontratave

Grafiku 3.19 Paga mujore e punonjësve

Grafiku 3.20 Afati i marrjes së pagës

Grafiku 3.21 Puna me orar të zgjatur

Grafiku 3.22 Pagesa për orët shtesë

Grafiku 3.23 Vlerësimi i kushteve të punës

Tabelat

Tabela 3.1 Periudha e fillimit të efekteve të krizës.....

Tabela 3.2 Shkaqet e pakësimit të shitjeve

Tabela 3.3 Numri i punonjësve me kohë të plotë në 3 mujorin e parë 2012 krahasuar me 3-mujorin e parë 2011 (Studimi i ACIT, 2012).....


Tabela 2.1 Eksportet e përpunimit aktiv sipas dy sektorëve							
	2006	2007	2008	2009	2010	% ndaj totalit për 2012	Ndryshimi i normës 2012/2011
Eksportet totale të përpunimit aktiv	54,301	64,464	67,370	65,308	85,423	-	-
Sektorët	mln lek	mln lek	mln lek	mln lek	mln lek	Në %	Në %
Tekstile dhe artikujt e tyre	21,584.44	26,300.13	29,523.67	28,010.34	30,051.35	35.2	7.3

Këpucët	19,959.65	20,503.48	18,999.64	20,043.39	25,381.80	29.7	26.6
----------------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------	------	------

Tabela 2.2 Treguesit makroekonomikë të tregëtisë në Shqipëri (në milion lekë)						
	2007	2008	2009	2010	2011	2012
GDP real (norma vjetore e rritjes në %)	5.7	5.4	5.9	7.7	3.3	3.9
Flukset tregëtare	326,023	375,720	474,602	551,622	534,546.30	641,200
Eksporti	65,818	77,441	97,155	112,539	103,438.84	161,009
Importi	260,205	298,279	377,447	439,083	433,107.43	480,191
Deficiti tregëtar	194,387	220,838	280,292	326,544	327,669	319,582
Rritja e exporteve (%)	6.0	17.7	25.5	15.8	-8.1	11.4


Grafiku 1.1

Peshat në % të dy sektorëve ndaj eksporteve dhe importeve totale



Grafiku 2.1


Zbatimi i simboleve të standarteve UPC





Burimi: OECD, 2009

Grafiku 2.3

Zhvillimi i linjave të reja të produkteve




Burimi: OECD, 2009



Grafiku 3.2

Pronësia e firmave



Grafiku 3.3

Madhësia e firmave bazuar në numrin e punonjësve






Tabela 3.1 Periudha e fillimit të efekteve të krizës		
Periudhat	Numri I firmave	Në %
3mujori i katërt 2009	5	38.47
3 mujori i pare 2010	4	30.77
3 mujori i tretë 2011	2	15.38
3 mujori i parë 2012	2	15.38



Grafiku 3.5


Shitjet në 2012/2011



Burimi: Studimi i ACIT , 2010


Grafiku 3.6

Shitjet në 2010 në krahasim me 2009



Grafiku 3.7

Shitjet në tremujorin e parë 2011/tremujorin e parë 2010



Grafiku 3.8 Deklaratat e eksportit për çdo tremujor 2007- 3 M.I. 2011 në Rajonin e Korçës





Tabela 3.2 Shkaqet e pakësimit të shitjeve

Shkaqet	Numri i firmave	Në %
Rrënia e kërkesës në tregjet e eksportit	9	62.23
Mungesa e likuiditetit	9	62.23
Mosrespektimi apo anulimi i kontratave nga kompanite porositëse	1	7.6
Pakësimi i furnizimit me lëndë të parë apo material të tjera të nevojshme nga kompania porositëse	2	15.38


Grafiku 3.9

Rezultati financiar (fitimi)




Grafiku 3.10

Rezultati financiar në 3 M I 2011/ 3M I 2010




Grafiku 3.11

Numri i punonjësve me kohë të plotë në 2009/2008



Grafiku 3.12

Numri i punonjësve me kohë të plotë në 2009/2008



Burimi: Studim i ACIT ,2010

Grafiku 3.13

Numri i Punonjësve me kohë të plotë në 2010/2009







Tabela 3.3 Numri i punonjësve me kohë të plotë në 3 mujorin e parë 2012 krahasuar me 3-mujorin e parë 2011 (Studimi i ACIT, 2011)

Qytetet	Korça	Shkodra	Tirana
Numri total i firmave të përgjegjura	15	20	27
Ulje të numrit të punonjësve	4	6	9
Mosdryshim I numrit të punonjësve	5	9	14
Rritje e numrit të punonjësve	6	5	4




Grafiku 3.16

Sigurimi i punonjësve




Grafiku 3.17

Kontratat e punonjësve




Grafiku 3.18

Afati i kontratave




Grafiku 3.19

Paga mujore




Grafiku 3.20

Afati i marrjes së pagës




Grafiku 3.21

Puna me orar të zgjatur




Grafiku 3.22

Pagesa për orët shtesë



Grafiku 3.23

Vlerësimi i kushteve të punës



Literatura:

Dokumenti i BB “Shqipëria. Rritja e konkurrueshmrisë në Shqipëri” Raporti I. Tetor 2009

Dokumenti i BB:Albania. Building Competitiveness in Albania. Sector Case Studies: Apparel and Footwear, Tourism, Mining. Raporti II. Tetor 2009 (shqip+anglisht)
ACIT. “Albania Trade Report 2010”

1. Analiza e Nevojave për Trajnimin e SME-ve (RAPORTI ANT) ,2010

ACIT: “Social Dimensions of the Global Crisis in Albania”. The Fashion Industry as a Case Study. Qershor 2010.

OECD “Sector Specific Sources of Competitiveness in the Eastern Balkans”. 2009

OECD “Private Sector Development Division. Investment Compact for South East Europe”. Maj 2008

Albania Shoe and Leather Sector. Në inëard investment opportunities. Qershor 2005

Strategjia e Zhvillimit të Bizneseve dhe investimeve 2007-2013. Qershor 2007

QKZH “Rezultatet e vrotimit të biznesit dhe konsumatorëve”. Shtator 2007

INSTAT , publikime për ecurinë e eksporteve të fasonit.

Gujarati, D.N., Basic Econometrics. 4th Edition. Boston: McGraw Hill, Inc, (2003)

Haderi Sulo (2006), " Paraja, Bankat dhe Tregjet Financiare", ribotimi 4, Tiranë

Heston, A. (1994). A brief review of some problems in using national accounts data in level of output comparisons and growth studies. Journal of Development Economics,

Judge G.G., R.C. Hill, E.E. Griffiths, H. Lutkepohl and T. Lee (1988) Introduction to the Theory and Practice of Econometrics (Second Edition). New York: John Wiley & Sons

Khan, M.S. and A.S. Senhadji. “Financial Development and Economic Growth: An Overview.” IMF Working Paper, WP/00/209, (December 2000).

King, R. G., Levine, R. (1993). Finance and growth: Schumpeter might be right. Quarterly Journal of Economics, Vol. 108,

King, R. G. and R. Levine, 1993b, Finance, Entrepreneurship, and Growth: Theory and Evidence, Journal of Monetary Economics

Levine, R. (2004). Finance and Growth: Theory and Evidence, Working Paper Series N. 10766.

Liu, X. and Shu, C. (2002). The Relationship between Financial Development and Economic Growth. Studies in Economics and Finance, 20, 2002, pp 76-84.

Ministry of Finance of the Republic of Macedonia (2011). Pre-accession Economic Program 2011-2013,- Macroeconomic Policy, Public Finances and Structural Reforms.

Mishkin Frederic S. (2004), The Economics of Money, Banking and Financial Markets”, Seventh Edition, Columbia University.

Mishkin Frederic S., Stanley G Eakins, (2008), Financial Markets and Institutions.

Odedokun, M.O. “Alternative econometric approaches for analysing the role of the financial sector in economic growth: Time-series evidence from LDCs.” Journal of Development Economics

Ramanathan, Ramu (2010) . Introductory econometrics with applications, 5th, Schiller Bradley R. (2009), The Macro Economy Today, seventh edition, McGraw-Hill, Inc.

Mishkin Frederic S. (2004), The Economics of Money, Banking and Financial Markets”, Seventh Edition, Columbia University.

Mishkin Frederic S., Stanley G Eakins, (2008), Financial Markets and Institutions.

Odedokun, M.O. “Alternative econometric approaches for analysing the role of the financial sector in economic growth: Time-series evidence from LDCs.” Journal of Development Economics

Ramanathan, Ramu (2010) . Introductory econometrics with applications, 5th, Schiller Bradley R. (2009), The Macro Economy Today, seventh edition, McGraw-Hill, Inc.

Shan, J., Morris, A., Sun, F. (2001). Financial Development and Economic Growth: An Egg – and - Chicken Problem?, Review of International Economics, Vol. 9,

Sinha, D., Macri, J. (1999). Financial Development and Economic Growth: The Case of Eight Asian Countries. Macquarie Economics Working Paper No. 7/99.

Upton, G., Cook, I., (2008). A dictionary of Statistics .Oxford University Press.

Vogelvang, Ben. (2005). Econometrics , theory and applications with EVIEWS. Pearson Education Limited

Web-page :

www.minfin.gov.al

www.imf.org,

www.oecd.org,

www.worldbank.org

www.noa.al

www.infoarkiv.com